

Misioni i Bashkimit Evropian Për Vëzhgimin e Zgjedhjeve

Raporti përfundimtar Kosovë 2014



ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË KOSOVË

ZGJEDHJET¹ PARLAMENTARE NË KOSOVË

8 QERSHOR 2014

RAPORT PËRFUNDIMTAR

7 KORRIK 2014

MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR VËZHGININ E ZGJEDHJEVE

Ky raport është përpiluar nga Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EOM) dhe prezanton gjetjet e EU EOM mbi Zgjedhjet Parlamentare të mbajtura më 8 qershor 2014 në Kosovë. Informacionet dhe opinionet e paraqitura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. Raporti është i disponueshëm në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Vetëm versioni në gjuhën angleze i raportit duhet të konsiderohet si version zyrtar. Kopjimi autorizohet me kusht që burimi të citohet.

¹ Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999) dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE	1
II. HYRJE	3
III. HISTORIKU POLITIK	3
A. Konteksti politik	3
B. Akterët kryesor politik	4
IV. KORNIZA LIGJORE	4
A. Zgjedhjet e parakohshme	5
B. Sistemi zgjedhor dhe ndarja e ulëseve	6
C. Përfaqësuesit e përfaqësuesve jo-shumicë në Organet e Menaxhimit të Zgjedhjeve	7
D. Gjinia	7
V. ADMINISTRATA E ZGJEDHJEVE	8
A. Struktura e administratës së zgjedhjeve	8
B. Administrimi i zgjedhjeve	8
VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE	10
VII. VOTIMI JASHTË KOSOVËS	10
VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE CERTIFIKIMI	1
IX. AMBIENTI I FUSHATËS	11
A. Financimi i fushatës	13
X. AMBIENTI I MEDIAVE	14
A. Peizazhi i mediave	14
B. Korniza ligjore	15
C. Gjetjet nga monitorimi i mediave	16
XI. DREJTËSIA ZGJEDHORE DHE ZBATIMI I TË DREJTAVE ZGJEDHORE	18
A. Parashtresat dhe ankesat	18
XII. VËZHGIMI VENDOR	22
XIII. VOTIMI DHE NUMËRIMI	22
XIV. NUMËRIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE	24
XV. PROCEDURA E FORMIMIT TË QEVERISË	
XVI. REKOMANDIMET	26
SHTOJCAT	34

I. PËRMBLEDHJE

Zgjedhjet e parakohshme të datës 8 qershor 2014 për Kuvendin e Kosovës me 120 ulëse janë zgjedhjet e dyta parlamentare që mbahen pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, dhe zgjedhjet e para parlamentare që mbahen në tërë Kosovën sipas ligjeve të Kosovës, pas Marrëveshjes së Brukselit për normalizim të marrëdhënieve Beograd-Prishtinë. Zgjedhjet ishin transparente dhe konsoliduan progresin e bërë në zgjedhjet komunale të vitit 2013. Korniza ligjore që ka rregulluar zgjedhjet e kaluara parlamentare dhe lokale ka mbetur në fuqi edhe për këto zgjedhje. Në përputhje me Kushtetutën, sistemi i ulëseve ‘të rezervuara’ për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë, i përdorur si masë e përkohshme për dy legjislaturat e kaluara, është zëvendësuar me sistemin e përhershëm të ndarjes së 20 ulëseve të ‘garantuara’. Përkundër një numri përpjekjesh për të reformuar sistemin zgjedhor në Kosovë, nuk janë adresuar të metat e identifikuar gjatë dy proceseve të kaluara zgjedhore. Sidoqoftë, legjislacioni ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në kushtetutën e saj. Periudha e shkurtër kohore e zgjedhjeve të parakohshme, megjithatë, ndikoi negativisht në disa aspekte të procesit.

Vendimi për të shpallur zgjedhjet e parakohshme vetëm 31 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit, edhe pse ligjor, pati implikime sa i përket zhvillimit të mirë dhe transparencës së procesit zgjedhor. Fushata zyrtare zgjati vetëm dhjetë ditë, duke kufizuar mundësinë e partive politike për të zhvilluar fushatë dhe duke ndikuar në të drejtën e votuesve për t’u informuar. Afatet e të gjitha fazave të kalendarit të fushatës u shkurtuan, që në veçanti pati ndikim në votimin jashtë Kosovës dhe në periudha kohore ligjore parazgjedhore, duke ndikuar në disa raste edhe në ushtrimin e plotë të së drejtës së votuesve dhe në mundësinë e tyre të kërkojnë mjetin e fundit ligjor.

Zgjedhjet kanë kaluar qetë dhe pa ndonjë incident të madh. Qytetarët kanë shprehur të drejtën e tyre për të votuar, përfshirë edhe në veri. Hapja, votimi dhe procedurat përmbyllëse në Ditën e Zgjedhjeve janë vlerësuar pozitivisht nga vëzhguesit e EU EOM, që paraqet përmirësim të dukshëm krahasuar me zgjedhjet e kaluara. Janë raportuar disa raste të keqpërdorimit, që në shumicën e rasteve janë adresuar nga autoritetet relevante. Vëzhguesit kanë vërejtur numër të lartë të votimit të asistuar, një trend që ka shqetësuar subjektet politike të cilat e kanë ndërlidhur këtë me shpërdorim. Vëzhguesit vendorë dhe vëzhguesit e partive politike kanë qenë të pranishëm në vendvotime në numër të madh. Performanca e komisioneve të vendvotimeve është përkeqësuar gjatë procesit të numërimit, i cili ka qenë i organizuar më dobët. Numërimi i preferencave për partitë dhe kandidatët në fletëvotime u paraqit si sfidë, duke rezultuar në një numër të madh të formularëve të rezultateve të plotësuar gabimisht.

Regjistrimi i kandidatëve ka qenë gjithëpërfshirës. KQZ ka certifikuar 30 subjekte politike: 18 parti politike, shtatë iniciativa qytetare, katër koalicione dhe një kandidat të pavarur. Njëzet e një subjekte janë certifikuar si përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë.

Në pjesën më të madhe të Kosovës ka pasur fushatë dinamike, e bazuar kryesisht në fushatë të drejtpërdrejtë derë-më-derë dhe takime me numër të vogël të pjesëmarrësve, për shumicën e subjekteve politike, e plotësuar në rastin e akterëve më të mëdhenj me përdorimin e billbordeve, tubimeve, rrjeteve sociale dhe transmetimit në media me pagesë. Garuesit patën mundësi të bënin fushatë lirshëm dhe fushata u intensifikua në ditët e fundit. Kandidatët u fokusuan në çështje ekonomike dhe sociale më shumë se sa në retorikë nacionaliste, dhe nuk është përdorur gjuhë nxitëse.

U dëshmuar se akterët kryesor përfituan nga periudha e shkurtër kohore e caktuar për fushatë zyrtare, pasi shfrytëzuan javët e parregulluara me ligj para datës zyrtare për fillim të fushatës për të mbajtur tubime publike dhe paraqitje mediatike ndërsa subjektet më të vogla dhe ato jo-shumicë nuk u vërejtën aq shumë. Kjo ishte në veçanti e dukshme në media ku që të gjashtë partitë parlamentare shqiptare të Kosovës bënë fushatë, me ç’rast PDK ka pasur më shumë hapësirë

mediatike në televizionin publik RTK1. Këto 20 ditë të parregulluara të para-fushatës, që paraqesin periudhë kohore dy herë më të gjatë se sa fushata zyrtare, tregojnë se masat për të siguruar terren të barabartë gare kanë qenë në fuqi vetëm gjatë një të tretës së periudhës *de facto* të fushatës. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) po ashtu ka dhënë pesë vërejtje për publikim të spoteve reklamuese politike apo deklarime partiake para fillimit zyrtar të fushatës.

Në përgjithësi është respektuar liria e mediave. Mediat u kanë ofruar subjekteve politike mënyra të ndryshme për shpërndarjen e mesazheve të tyre tek votuesit, si dhe u kanë ofruar informacione të nevojshme për të bërë një zgjedhje të informuar. Përderisa raportimi i lajmeve nga fushata zyrtare në përgjithësi ka qenë i balancuar dhe i drejtë, mbulimi i gjerë gjatë kohës me shikueshmëri të lartë i partive politike përmes hapësirës së parregulluar për transmetim të sponsoruar, përpos spoteve reklamuese politike të rregulluara, ka zvogëluar balancën në mbulueshmëri. Kanalet televizive, duke shfrytëzuar zbrazëtinë ligjore, aplikuan çmime të negociuara për mbulimin e sponsoruar, gjë që dëmton barazinë e garuesve të paraparë me ligj.

Komuniteti serb ka hyrë në procesin zgjedhor i pakënaqur për shkak të skadimit të sistemit të ulëseve 'të rezervuara' dhe përdorimit për herë të parë të sistemit të ulëseve 'të garantuara'. Dallimet në terminologjinë e përdorur në ligj dhe Kushtetutë e kanë rritur këtë pakënaqësi. Përgatitjet për zgjedhje ishin pezulluar përkohësisht nga kryetarët e katër komunave veriore dhe Lista Serbe ndaloi fushatën e saj, gjë që zmbropsi subjektet e vogla politike serbe dhe të minoriteteve nga bërja e një fushate të dukshme në veri, dhe kjo ka ndikuar në të drejtën e votuesve për t'u informuar për kandidatët dhe për atë se si të shprehin zgjedhjen e tyre në fletëvotim. Në zonat me shumicë serbe në jug, të gjitha subjektet politike bënë fushatë lirshëm dhe pa incidente. Lista Serbe rifilloi aktivitetet e saj të fushatës atje gjatë tre ditëve të fundit të fushatës.

Subjektet politike të shqiptarëve të Kosovës edhe ato jo-shumicë ua drejtuan mesazhet e tyre ekskluzivisht komunitetit të tyre dhe vetëm në një gjuhë, duke përqendruar aktivitetet në zonat gjeografike të popullatës së tyre, duke mos iu drejtuar votuesve të tjerë. Debatet televizive nuk kanë kombinuar kandidatë përfaqësues të komuniteteve të ndryshme.

Gratë ishin të nën-përfaqësuar në fushatë, veçanërisht në paraqitjet publike dhe media, me përjashtim të disa garuesve kyçe të dy partive kryesore. Mesazhet nuk kanë pasur në shënjestër në mënyrë specifike gratë dhe pjesëmarrja e tyre në tubime ka qenë e vogël. Po ashtu, gratë ishin të nën-përfaqësuar edhe në organet e menaxhimit të zgjedhjeve. Përfaqësimi i grave në Kuvendin e Kosovës është i garantuar përmes sistemit të kuotës me 30 për qind si në listat e kandidatëve ashtu edhe në ulëse – masë e cila nga EOM dhe shumica e bashkëbiseduesve është vlerësuar si e domosdoshme për të siguruar përfaqësimin e grave.

Të gjitha nivelet e administratës së zgjedhjeve kanë kryer punën e tyre në mënyrë transparente. Përkundër periudhës së shkurtër kohore, administrata e zgjedhjeve ka organizuar mirë zgjedhjet në nivelin teknik, duke përmbushur shumicën e afateve operacionale, përfshirë trajnimin e komisioneve të vendvotimeve, shtypjen e manualeve dhe fletëvotimeve, dhe shpërndarjen e materialit zgjedhor. Sidoqoftë, disa nga vonesat në marrjen e vendimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve nga KQZ nuk kanë rritur besimin e publikut në punën e saj. Për shembull, përkundër diskutimeve të shumta mbi procedurën për ndarjen e ulëseve në Kuvend, formula e saktë është vënë në dispozicion vetëm disa ditë para Ditës së Zgjedhjeve.

Lista përfundimtare e votuesve, që menaxhohet nga KQZ-ja por që bazohet në regjistrin civil, përmbante 1,782,454 votues. Përkundër përpjekjeve të kohëve të fundit për të përditësuar regjistrin civil, ende mendohet se ai përmban numër të madh të personave të vdekur dhe të gabimeve në regjistrim. Periudha kohore që votuesit të kundërshtojnë listën preliminare të votuesve në këto zgjedhje është shkurtuar në vetëm tri ditë dhe nuk është administruar si duhet në të gjitha komunat. Vlerësohet se gjysmë milioni njerëz që nuk jetojnë në Kosovë gjenden në listën e votuesve, meqë

kjo lejohet me ligj. Subjektet politike kanë frikë se ky numër i madh i votuesve nga diaspora e lë të hapur mundësinë për manipulime gjatë procesit.

Kriteret për të drejtën e votimit në programin për votim jashtë Kosovës janë gjithëpërfshirëse dhe procedurat janë të qartësuara mirë nga KQZ-ja. Nga 29,754 aplikacione, janë pranuar më shumë se 16,000 persona dhe 15,951 persona kanë votuar. Megjithatë, votimi jashtë Kosovës ka qenë një nga pjesët më kundërtëhënëse të procesit zgjedhor. Periudhat kohore për aplikim dhe votim kanë qenë tejet të shkurtra. Votuesit të cilët janë ankuar me sukses kundër vendimeve mbi aplikacionet e tyre, si pasojë, mund të kenë mos pasur mundësi të votojnë. Për më shumë, ankuesit e pasuksesshëm nuk kanë pasur kohë të kërkojnë shfrytëzimin e mjetit të fundit ligjor para Ditës së Zgjedhjeve. Gjatë numërimit të fletëvotimeve prej jashtë Kosovës, përfaqësues të një numri të partive politike kanë dal jashtë në shenjë proteste, duke pretenduar se shumë fletëvotime të Listës Serbe ishin plotësuar nga një person i njëjtë. Edhe pse asnjë nga ankesat e ngjashme nuk janë pranuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), shumica e partive kryesore politike kanë raportuar për një mungesë besimi në votimin jashtë Kosovës. EU EOM ka vërejtur mungesë të garancive për të siguruar që edhe aplikacionet edhe votimi janë autentike dhe pa manipulime.

Procesi pas zgjedhjeve ka zgjatur 26 ditë para se të shpallen rezultatet përfundimtare, të certifikuar. Kjo pjesërisht është shkaktuar nga sistemi i votimit me kusht, me ç'rast është dashur që 798 kuti të votimit me kusht si edhe fletëvotimet prej jashtë Kosovës të numërohen në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Megjithatë, mospërputhjet në formularët e rezultateve çuan deri te kontrollimi i 538 formularëve të përputhjes së të dhënave dhe të rezultateve dhe 939 formularëve të rezultateve të kandidatëve dhe në një vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për ri-numërim të plotë të 439 kutive të votimit – pothuajse një e pesta e të gjitha vendvotimeve. EU EOM ka vlerësuar se të gjitha procedurat në QNR janë ndjekur me korrektësi, por ritmi i ngadaltë i verifikimit të të dhënave të vendvotimeve dhe aktivitetet e ri-numërimit kanë vonuar shpalljen e rezultateve. Përderisa QNR ka qenë e organizuar mirë, numri i ekipeve të numërimit është rritur vetëm një javë pas fillimit të procesit dhe ekipet kanë arritur kulmin e efikasitetit vetëm gjatë ditëve të fundit kur është bërë trysni nga partitë politike për shpallje të rezultateve.

Sistemi i tanishëm i kontesteve zgjedhore është treguar si i papërshtatshëm për sigurimin e të drejtave zgjedhore të të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje. Kjo vlen posaçërisht në rastet që kanë të bëjnë me kontestet lidhur me votimin dhe numërimin, ku shumica dërmuese e ankesave janë refuzuar mbi baza formale ose për shkak të mungesës së provave. Në shumë raste, PZAP ka pasur një qasje formaliste dhe jo gjithëherë ka hulumtuar në mënyrë proaktive për prova.

Në përgjithësi rezultatet e zgjedhjeve janë pranuar nga subjektet politike të shqiptarëve të Kosovës, madje edhe nga subjektet që kanë humbur përfaqësimin e tyre në Kuvend. Edhe pse kanë pranuar rezultatet, disa subjekte politike jo-shumicë, përfshirë Listën Serbe, vazhdojnë të kontestojnë legjitimitetin e sistemit të ulëseve të garantuara. PDS – një parti tjetër serbe që ka fituar përfaqësimin në Kuvend – dhe PDP, të dy këto parti kanë parashtruar ankesa lidhur me integritetin e procesit të votimit jashtë Kosovës përmes të cilit kanë fituar ulëse pesë kandidatë të Listës Serbe.

Pasi që asnjëra nga partitë apo koalicionet parazgjedhore nuk fitoi shumicën e ulëseve në Kuvend, partia më e madhe, PDK, dhe koalicioni paszgjedhor AAK, LDK dhe Nisma, të përkrahur nga Vetëvendosje, pretendonin të drejtën që të kërkohej nga ata të formojnë qeverinë, duke paraqitur interpretime të ndryshme të Kushtetutës. Me kërkesën e Presidentes, Gjykata Kushtetuese ka dhënë një sqarim për këtë çështje. Interpretimi i saj, që lejon mundësinë – edhe pse nuk e përshkruan – që partisë ose koalicionit më të madh parazgjedhor t'i jepen të dy mundësitë e parapara me kushtetutë për të formuar qeverinë, lë të hapur mundësinë që, ose tani ose në të ardhmen, koalicioni paszgjedhor që përfaqëson shumicën e deputetëve të zgjedhur të Kuvendit mund të mos ftohet për të formuar qeverinë. Kjo tregon për një të metë në Kushtetutë dhe kjo mund të paraqes një sfidë për respektimin e vullnetit të votuesve.

II. HYRJE

Pas ftesës së datës 8 maj 2014 dërguar Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë dhe Zëvendës-Kryetares së Komisionit Evropian, Catherine Ashton, me 20 maj 2014 u krijuar Misioni i BE për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 8 qershorit. EOM u udhëhoq nga Kryesuesi i Vëzhguesve Roberto Gualtieri, deputet në Parlamentin Evropian. EU EOM ka shpërndarë gjithsej 96 vëzhgues nga të gjitha shtetet anëtare të BE, Norvegjia dhe Zvicra, përfshirë një ekip të tetë analistëve të zgjedhjeve me seli në Prishtinë dhe 20 vëzhguesve afatgjatë në tërë Kosovën. EU EOM vepron sipas Deklaratës së Parimeve për Vëzhgim Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.

EU EOM ka vlerësuar tërë procesin zgjedhor në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe ligjet e Kosovës. Në këtë raport janë paraqitur gjetjet e EU EOM, me rekomandime për të ndihmuar në përmirësimin e zgjedhjeve të ardhshme në Kosovë. Edhe pse Kosova zyrtarisht nuk është e detyruar të ndjekë standardet zgjedhore të përcaktuara nga OSBE dhe Këshilli i Evropës, është me rëndësi të theksohet se këto janë standardet që mbizotërojnë në rajon. Pasi Kosova aspiro integrimin në këto struktura rajonale, EOM e ka konsideruar të dobishme të bazojë edhe rekomandimet e veta në këto standarde ekzistuese rajonale, në mënyrë që të ndihmojë autoritetet e Kosovës në përpjekjet e tyre për përmirësim të zgjedhjeve të ardhshme sipas standardeve të miratuara dhe aplikuara në vendet e saj fqinje.

EU EOM dëshiron të shpreh falënderimin e tij për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe autoritetet tjera, partitë politike, shoqërinë civile dhe organizatat e mediave për bashkëpunimin e ofruar dhe ndihmën e dhënë gjatë vëzhgimit. EU EOM po ashtu falënderon edhe Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Misionin Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, dhe misionet diplomatike të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për mbështetjen e tyre gjatë tërë kohës.

III. HISTORIKU POLITIK

A. Konteksti politik

Kosova ka shpallur pavarësinë në shkurt të vitit 2008. Me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të datës 10 qershor 1999, Kosova është vënë nën administrim të përkohshëm të OKB-së (UNMIK). Në shkurt të vitit 2007, i Dërguari i Posaçëm i OKB-së, Martti Ahtisaari, paraqiti propozimin e tij për 'pavarësi të mbikëqyrur', i cili nuk u pranua nga Beogradi. Sidoqoftë, hapat e planit u ndoqën dhe me deklarin e pavarësisë, Kosova u zotua se do të përmbush obligimet e saj që dalin nga plani i Ahtisaarit. Në shtator të vitit 2012 zyrtarisht përfundoi mbikëqyrja ndërkombëtare dhe Kosova mori përgjegjësitë për qeverisjen e saj.

Zgjedhjet e parakohshme të vitit 2014 për Kuvendin e Kosovës janë zgjedhjet e dyta parlamentare që mbahen pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, dhe zgjedhjet e para parlamentare që mbahen në tërë Kosovën sipas ligjeve të Kosovës, pas Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve Beograd-Prishtinë. Meqë ka pasur pretendime për parregullsi të shumta gjatë zgjedhjeve të vitit 2010 për Kuvendin e Kosovës, zgjedhjet e vitit 2014 ishin po ashtu një test i rëndësishëm i besueshmërisë.

Zgjedhjet e parakohshme u shpallën më 8 maj nga Presidentja Atifete Jahjaga, pas votimit për shpërndarje të Kuvendit. Ky votim u bë me iniciativën e koalicionit qeverisës të PDK-së, mbështetur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në opozitë dhe deputetët serbë të Kosovës

(SLS), dhe votimi kishte kaluar kundër vullnetit të partisë së tretë më të madhe, Vetëvendosje dhe AKR, dhe pa konsultimin e akterëve më të vegjël (përfshirë subjektet politike jo-shumicë).

Kuvendi i Kosovës ka 120 ulëse. Gjatë mandateve të vitit 2007 dhe 2010, si masë kalimtare e përcaktuar me Planin e Ahtisaarit, 20 ulëse ishin rezervuar për subjektet politike jo-shqiptare (dhjetë për serbët dhe dhjetë për komunitetet e tjera jo-shumicë), të cilave u shtoheshin ulëset e fituara sipas rezultateve të votimit. Në këto zgjedhje, për herë të parë është aplikuar sistemi i ulëseve të garantuara i përcaktuar me Kushtetutë, sipas të cilit, së paku 10 ulëse janë të garantuara për serbët, dhe 10 për përfaqësuesit e tjerë jo-shumicë, pa marrë parasysh numrin e votave të tyre. Ndryshimi në sistem ka qenë shkak i pakënaqësisë në radhët e komunitetit serb.

Zgjedhjet Komunale të datës 3 nëntor dhe 1 dhjetor 2013 ishin një hap i rëndësishëm përpara sepse ishin zgjedhjet e para që u mbajtën në tërë Kosovën, përfshirë edhe katër komunat veriore me shumicë serbe, atë të Mitrovicës Veriore, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, sipas ligjeve të Kosovës. Këto zgjedhje, për mbajtjen e të cilave në komunat veriore ishte e nevojshme ndihma e OSBE-së, çuan në zgjedhjen e përfaqësuesve komunalë në veri. Për zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, OSBE ofroi ndihmë teknike në veri dhe transportin për në Serbi dhe nga Serbia për votimin jashtë Kosovës.

B. Akterët kryesor politikë

Tridhjetë subjekte politike – koalicione, parti, iniciativa qytetare dhe një kandidat i pavarur – janë certifikuar nga KQZ si pjesëmarrës në votime. Prej tyre nëntë ishin shqiptare të Kosovës, dhe 21 përfaqësonin komunitetet jo-shumicë.

Dy garuesit kryesorë ishin koalicioni “Misioni i Ri” i udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Pas humbjes së përkrahjes në zgjedhjet komunale të një viti më herët, lideri i PDK-së dhe Kryeministri Hashim Thaçi, që ishte në krye të qeverisë gjatë dy mandateve të njëpasnjëshme, formoi një koalicion në përpjekje për të fituar më shumë vota, me ndihmën e njërit nga partnerët e saj në qeveri, PD (Partia e Drejtësisë), dhe disa parti të vogla. Partia opozitare, LDK, e udhëhequr nga Isa Mustafa ishte rivali i tij më i madh, që mbante 29 ulëse. Vetëvendosje ishte garuesi i tretë, e përfaqësuar për herë të parë në Kuvend në vitin 2010, me 14 ulëse, dhe e cila fitoi zgjedhjet për kryetar të komunës së Prishtinës në vitin 2013. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e udhëhequr nga ish komandanti i UÇK Ramush Haradinaj ishte tjetra me radhë. Akterët e tjerë relevantë shqiptarë të Kosovës ishin Aleanca Kosova e Re e Behgjet Paçollit (AKR), nga koalicioni qeverisës, që kësaj radhe po garonte vetëm, pasi kishte fituar zgjedhjet komunale në Gjakovë dhe Mitrovicë në vitin 2013; dhe subjekti i sapokrijuar Nisma (Nisma për Kosovën), parti e krijuar nga bashkë-themeluesit e PDK-së dhe ish-pjesëtarët e UÇK-së, Fatmir Limaj dhe Jakup Krasniqi, e cila po garonte për herë të parë në zgjedhjet parlamentare.

Me qëllim të formimit të një blloku me së paku 10 ulëse në Kuvend, tri subjektet kryesore politike të serbëve të Kosovës, që kishin garuar kundër njëri tjetrit në vitin 2013, formuan një listë të përbashkët – Listën Serbe. E udhëhequr nga Iniciativa Qytetare Serbe që mbështetej nga Beogradi dhe që ishte themeluar për zgjedhjet komunale, ky koalicion përfshinte iniciativën qytetare të serbeve të veriut SDP-Oliver Ivanović dhe Partinë e Pavarur Liberale (SLS), që ishte pjesë e Qeverisë së Kosovës, në jug. Garuesi tjetër kryesor serb ishte Partia Progresive Demokratike Serbe (PDS), edhe në jug edhe në veri.

Dy koalicione ishin formuar nga komunitetet e tjera jo-shumicë: Koalicioni për Gorën (KZG) dhe Lista e Bashkuar e Boshnjakëve (BJL). Kanë qenë edhe pesë subjekte të tjera të boshnjakëve, dy të turqve, dy të ashkalive, dy të egjiptianëve dhe dy të romëve.

IV. KORNIZA LIGJORE

Legjislacioni i Kosovës ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike. Që nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, janë bërë dy përpjekje të pasuksesshme për reformimin gjithëpërfshirës të sistemit zgjedhor në Kosovë dhe për adresimin e të metave të identifikuara në të kaluarën. Me disa përjashtime, korniza ligjore me të cilën janë mbajtur zgjedhjet e kaluara parlamentare dhe lokale ka mbetur në fuqi edhe për Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2014. Ka ndryshuar vetëm legjislacioni penal lidhur me shkeljet e të drejtave elektorale, duke e ashpërsuar ligjin lidhur me veprat penale kundër të drejtave zgjedhore.

Pjesët kryesore të legjislacionit në Kosovë janë Kushtetuta e Kosovës e datës 15 qershor 2008 dhe Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i datës 5 qershor 2008, që është ndryshuar në tetor të vitit 2010 për të bërë disa ndryshime kryesisht lidhur me procedurat për parashtresa dhe ankesa. Legjislacioni sekondar përkatës përfshin Rregulloren e Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 4 shtator 2008, që përkufizon funksionimin e këtij organi; Rregullorja e Punës së PZAP-së, që e zgjeron fushëveprimin e ligjit edhe për paraqitjen e parashtresave dhe ankesave; dhe 17 rregulloret e lëshuara në vitin 2013 nga KQZ, që i përkufizojnë më tej parimet e përfshira në LZP.

Ligjet e tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve janë Ligji mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDK), i ndryshuar në dhjetor të vitit 2011 dhe gusht të vitit 2012; dhe Ligji mbi Financimin e Subjekteve Politike i datës 16 shtator 2010, i ndryshuar në dhjetor të vitit 2011 dhe korrik të vitit 2013.

Kosova nuk është palë nënshkruese e asnjë dokumenti ndërkombëtar për të drejtat e njeriut apo për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Sidoqoftë, neni 22 i Kushtetutës thekson zbatimin e drejtpërdrejtë të një numri marrëveshjesh dhe instrumentesh të rëndësishme për zgjedhjet. Këto përfshijnë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MNDKP), Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollin e saj, Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW).

Për më shumë, neni 53 i Kushtetutës obligon autoritetet e Kosovës të interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me ligj dhe Kushtetutë në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të drejtat e përfshira në KEDNJ janë të aplikueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe në rast konflikti, kanë prioritet mbi dispozitat e ligjeve të Kosovës. Për më tepër, tre ditë pas zgjedhjeve Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi anëtarësimin e Kosovës në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si Komisioni i Venedikut. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut i tetorit të vitit 2002 tani ka rëndësi edhe më të madhe si referencë për zhvillim të zgjedhjeve demokratike në Kosovë.

Disa nga të metat në ligj të identifikuara nga EU EOM janë: e drejta e shkurtimit të afateve në kuadër të kalendarit për zgjedhje të parakohshme, përfshirë periudhën e fushatës; mungesa e qartësisë lidhur me atë se si duhet të bëhet ndarja e ulëseve përmes sistemit të garantimit të tyre për subjektet politike jo-shumicë; vet rregulla e përgjithshme e përfaqësimit etnik në organet menaxhuese të zgjedhjeve; dhe mungesa e garancive në ligj për të siguruar mundësi të barabartë të subjekteve politike në hapësirë transmetuese në media.

A. Zgjedhjet e parakohshme

Kushtetuta dhe LZP i mundësojnë Presidentit të Kosovës të shpall zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës nëse është shpërndarë Kuvendi. Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se 30 ditë apo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit. Dekreti Presidencial që ka caktuar datën e zgjedhjeve të parakohshme është nënshkruar me 8 maj, duke shpallur zgjedhjet me 8 qershor. Kjo ka qenë data më e hershme e mundshme. Zgjedhjet e parakohshme janë të rregulluara përmes ligjeve dhe rregullave të njëjta të KQZ-së si edhe zgjedhjet e tjera, përpos asaj që KQZ ka të drejtën të ndryshojë periudhat kohore nëse rrethanat e kërkojnë këtë. Në pajtim me këtë, KQZ prezantoi kalendarin ku ishin shkurtuar të gjitha afatet, përfshirë fushatën. Shkurtimi i afateve ndikon në zhvillimin e mirë dhe transparent të procesit zgjedhor. Afatet më të shkurtra kufizojnë kohën për: partitë politike për të bërë fushatë, duke ndikuar në të drejtën e votuesve për t'u informuar; aplikimet për votim jashtë Kosovës; përgatitjet për zgjedhje; dhe parashtresat dhe ankesat parazgjedhore. Në disa raste afatet e shkurtra kanë ndikuar në ushtrimin e plotë të të drejtave të votuesve dhe mundësinë e tyre për të kërkuar mjetin e fundit ligjor.

B. Sistemi zgjedhor dhe ndarja e ulëseve

Për qëllime të këtyre zgjedhjeve, Kosova është konsideruar si një zonë e vetme zgjedhore. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë të zgjedhur drejtpërdrejtë bazuar në lista të hapura. Prej 120 ulëseve, dhjetë ulëse janë të garantuara për serbët dhe dhjetë për komunitetet e tjera jo-shumicë.² Si garanci shtesë, për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë nuk aplikohet pragu prej 5% i cili aplikohet për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin shqiptar të Kosovës. Shpërndarja e ulëseve bëhet përmes përfaqësimit proporcional në pajtim me metodën Sainte-Laguë. Mandati i deputetëve të Kuvendit të Kosovës është katërvjeçar.

Gjatë tërë fushatës parazgjedhore dhe periudhës së fushatës është zhvilluar një debat i rëndësishëm lidhur me atë se si funksionon sistemi dhe se si do të ndahen ulëset në Kuvend. Edhe Kushtetuta e Kosovës edhe LZP parashohin sistemin e ulëseve 'të garantuara'. Edhe pse legjislacioni nuk ka ndryshuar, këto ishin zgjedhjet e para ku është zbatuar ky sistem i ndarjes së ulëseve, pas dy palë zgjedhjeve ku kanë qenë në fuqi masa kalimtare. Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar rregullën e përhershme të ulëseve 'të garantuara' por ka paraparë që sistemi i ulëseve 'të rezervuara' do të aplikohet vetëm për dy zgjedhjet e para të përgjithshme pas pavarësisë së Kosovës. LZP e thotë saktësisht të njëjtën gjë si Kushtetuta e Kosovës lidhur me krijimin e sistemit të ulëseve 'të garantuara'. Megjithatë, është përdorur fjala 'të rezervuara' për të shpjeguar se si do të ndahen ulëset, çka është interpretuar nga përfaqësuesit serb si diçka që lë të kuptohet se sistemi i ulëseve të rezervuara është ende në fuqi. Nën sistemin e mëparshëm të ulëseve 'të rezervuara', ku 20 ulëse të rezervuara ishin ndarë si shtesë e ulëseve të fituara sipas rezultateve, subjektet politike të komuniteteve jo-shumicë kishin gjithsej 25 përfaqësues në legjislaturën e kaluar.

Vetëm një javë para zgjedhjeve KQZ krijoi një Grup Punues i cili hartoi një dokument për të qartësuar procedurën e ndarjes së ulëseve në Kuvend.

C. Përfaqësimi i përfaqësuesve të jo-shumicës në organet menaxhuese të zgjedhjeve

Ligji nuk ofron garanci specifike për përfaqësim të komuniteteve jo-shumicë në të gjitha nivelet e administratës së zgjedhjeve. Ai vetëm kërkon që KQZ të bëjë përpjekje të sigurojë që të gjitha

² Shpërndarja e këtyre 20 ulëseve është si në vijim: 10 për komunitetin serb të Kosovës, 3 për komunitetin boshnjak, 2 për komunitetin turk, 1 për komunitetin goran, 1 për komunitetin romë, 1 për komunitetin ashkali, 1 për komunitetin egjiptian dhe një 1 ulësë shtesë për komunitetin rom, ashkali ose egjiptian me numrin më të madh të përgjithshëm të votave.

komunitetet etnike me numër të konsiderueshëm në komunat përkatëse të jenë të përfaqësuara drejt si anëtarë të komisioneve komunale zgjedhore (KKZ). Pastaj, komisionet e vendvotimeve (KVV) duhet në masë të gjerë të pasqyrojnë përbërjen e KKZ-së. Nuk aplikohen përqindjet dhe kuotat, dhe si rezultat, komunitetet jo-shumicë nuk janë ndier gjithherë se kanë qenë të përfaqësuara drejt në organet menaxhuese të zgjedhjeve.

D. Gjinia

Korniza ligjore e Kosovës siguron barazi gjinore edhe në Kushtetutë edhe në legjislacionin zgjedhor. Po ashtu ekziston edhe një Ligj specifik për Barazinë Gjinore. Kushtetuta parasheh që përbërja e Kuvendit të Kosovës duhet të respektojë parimet e njohura ndërkombëtarisht mbi barazinë gjinore. LZP thekson se në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik, së paku 30% e kandidatëve duhet të jenë femra. Për të pasur garanci të tjera shtesë për përfaqësim, nëse pas ndarjes së ulëseve kandidatëve të gjinisë së përfaqësuar më pak brenda subjektit politik nuk u janë ndarë së paku 30% të ulëseve të përgjithshme të këtij subjekti politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë do të zëvendësohet me kandidatin e radhës së gjinisë së kundërt në listën e riradhitur të kandidatëve derisa numri i përgjithshëm i ulëseve të ndara për gjininë pakicë të arrijë së paku 30%. Kjo masë mund të ketë qëllime të kundërta me sistemin e listave të hapura. Zbatimi i këtij 'diskriminimi të dyfishtë pozitiv' do të thotë se në praktikë nuk është respektuar gjithmonë vullneti i votuesve në përzgjedhjen e kandidatëve, meqë në disa raste femrave u janë caktuar ulëse edhe pse kanë marrë më pak vota se kandidatët meshkuj në listën e njëjtë. Edhe pse kjo ka qenë shkak për shqetësim për disa kandidatë meshkuj, nga shumica e palëve të interesit kjo është pranuar si masë e domosdoshme kalimtare. Është vërtetuar nga përfaqësues të disa partive politike se pa këto kuota, gratë nuk do të përfaqësoheshin në nivel të njëjtë në organet e zgjedhura.

Përkundër kuotave për përfaqësim politik të grave në Kosovë, partitë vazhdojnë të dominohen nga meshkujt dhe gratë në pozita vendim-marrëse vazhdojnë të jenë përjashtim nga kjo rregull. Po ashtu, gratë janë të nën-përfaqësuara në administratën e zgjedhjeve.

V. ADMINISTRATA E ZGJEDHJEVE

A. Struktura e administratës së zgjedhjeve

Zgjedhjet parlamentare janë administruar nga administrata e zgjedhjeve në tri nivele e përbërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që është organ i përhershëm, si dhe 38 komisione komunale zgjedhore (KKZ) dhe 2,374 komisione të vendvotimeve (KKV) të emëruara vetëm për këto zgjedhje.

KQZ është organ i pavarur dhe i centralizuar me përgjegjësi për menaxhimin dhe zbatimin e procesit të zgjedhjeve. Është organi i vetëm me kompetenca vendim-marrëse për të gjitha aspektet e zgjedhjeve dhe divizioni i tij teknik, Sekretariati, së bashku me KKZ-të, zbaton udhëzimet e tij. Përbëhet nga anëtarë që përfaqësojnë gjashtë grupet më të mëdha parlamentare të Kuvendit dhe katër grupet jo-shumicë. Kryetari caktohet nga Presidenti nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme për mandat shtatëvjeçar. Kryetari nuk mund të shërbejë më shumë se dy mandate. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të KQZ-së nuk është e përkufizuar me ligj. Takimet e KQZ-së janë publike, përpos në rastet kur KQZ vendos ndryshe, dhe ato duhet të thirren nga Kryetari i KQZ-së apo nga së paku katër anëtarë. Shumica e vendimeve merren me shumicë të thjeshtë. Megjithatë, për rregullat zgjedhore, regjistrimin dhe certifikimin e partive politike dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, KQZ duhet të vendos me konsensus. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë vendimi merret me shumicën prej dy të tretave. Vendimet e KQZ-së janë përfundimtare dhe ato mund të ankimohen vetëm nëse kjo parashihet me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme.

Sipas ligjit, anëtarët e KKZ emërohen nga subjektet politike të cilat e kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet parlamentare paraprake. Edhe pse legjislacioni është i heshtur sa i përket përbërjes së KVV-së, në thelb ai ka pasqyruar përbërjen e KKZ-së. Është bërë përjashtim për KKZ-të dhe KVV-të në katër komunat veriore ku përbërja ishte bazuar në kuvendet komunale të zgjedhura në vitin 2013.

B. Administrimi i zgjedhjeve

Të gjitha nivelet e administratës së zgjedhjeve kanë kryer punën e tyre në mënyrë transparente, me takime të hapura dhe duke u shpërndarë informacione palëve të interesuara dhe qytetarëve. Vëzhguesit vendorë dhe një numër i madh vëzhguesish të partive politike janë akredituar pa ndonjë pengesë të madhe. Megjithatë, faqja e internetit e KQZ-së nuk është përditësuar gjithmonë me kohë dhe në disa raste përkthimet e dokumenteve dhe udhëzimet në serbisht janë vënë në dispozicion shumë ngadalë ose kanë munguar tërësisht.

Përkundër periudhës së shkurtër kohore, administrata e zgjedhjeve i ka organizuar mirë zgjedhjet në nivelin teknik, duke iu ka përmbytur shumicës së afateve të saj operacionale, përfshirë shtypjen e manualeve dhe fletëvotimeve dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore. Trajnimi i KVV-ve në përgjithësi është vlerësuar pozitivisht nga vëzhguesit, përpos në Mamushë. Megjithatë, trajnimi për fazat e numërimit dhe plotësimin e formularëve të rezultateve është vlerësuar se nuk i ka përmbytur standardet, siç është pasqyruar në numrin e madh të formularëve të rezultateve të plotësuar gabimisht. Për më tepër, emërimi me vonesë i KKZ-ve dhe KVV-ve në veri ka ndikuar në cilësinë e trajnimit atje.

Vëzhguesit e EU EOM kanë vlerësuar se KKZ-të kanë pasur qasje profesionale gjatë ballafaqimit me vështirësi teknike, operacionale dhe logjistike. Megjithatë, ngrirja e operacioneve zgjedhore në katër komunat veriore e ka bërë të pamundur që KKZ-të të shfrytëzojnë ndërtesat komunale dhe si pasojë ka shkaktuar vonesa në trajnimin e KVV-ve.

KQZ ka organizuar një fushatë të gjerë për edukimin e votuesve, përfshirë edhe votuesit jashtë Kosovës. Fushata është zhvilluar në media³ dhe kryesisht ka pasur të bëjë me procedurat e votimit dhe dokumentet e nevojshme për identifikim në vendvotime. Edhe pse kërkohet me ligj, spotet edukative për qytetarët nuk kanë pasur në shënjestër ndonjë kategori të caktuar të njerëzve.

Në disa raste, vonesat e KQZ-së në marrjen e vendimeve dhe veprimeve nuk e kanë rritur besimin e qytetarëve në punën e tij. Përkundër diskutimeve të shumta mbi procedurën për ndarjen e ulëseve në Kuvend, formula e saktë është vënë në dispozicion vetëm disa ditë para ditës së zgjedhjeve. Një vendim i KQZ-së pak para fillimit zyrtar të fushatës për ndalimin e përdorimit të posterëve të caktuar ka qenë pakohshëm, duke shkaktuar pengesa të panevojshme për partitë në fushatë dhe i cili në fund u anulua nga PZAP. KQZ-ja po ashtu ka krijuar një grup punues për të shqyrtuar propozimin për të vendosur para ditës së zgjedhjeve që të bëhet rinumërimi i plotë i votave të të gjitha vendvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Kjo tregon një mungesë të besimit në KVV dhe do të kishte qenë në kundërshtim me ligjin

Ndonëse QNR ka qenë e organizuar mirë, ka pasur mungesë të urgjencës në procedurat e numërimit, që do të thotë se rezultatet përfundimtare nuk janë shpallur deri 18 ditë pas zgjedhjeve. Numërimi ka filluar ngadalë dhe QNR ka rritur numrin e ekipeve për numërim vetëm një javë pas fillimit të procesit. Produktiviteti i ekipeve të numërimit ka arritur kulmin vetëm në ditët e fundit kur është bërë trysni nga partitë politike për të shpallur rezultatet.

Pjesëmarrja e grave në të gjitha nivelet e administratës së zgjedhjeve është shumë e ulët. Në KQZ, vetëm Kryetarja është femër dhe përqindja është e vogël edhe në KKZ (11.7%). Në Ditën e Zgjedhjeve, më shumë se një e katërta e anëtarëve të KVV-ve ishin femra, por shumica kanë mbajtur pozita të tjera e jo të kryesuesit.

Sa i përket katër komunave veriore, KQZ ka kërkuar mbështetje teknike nga OSBE për organizim të zgjedhjeve. Roli i OSBE në katër komunat veriore ka qenë i kufizuar në krahasim me zgjedhjet e kaluara dhe kryesisht është fokusuar në udhëzimin e KKZ-ve, këshillimin dhe ndihmën teknike për KVV-të dhe ndihmën në transportimin e materialit zgjedhor. Për më shumë, OSBE ka ndihmuar në transportimin e aplikacioneve të votimit përmes postës. Gjatë Ditës së Zgjedhjeve, OSBE ka shpërndarë këshilltarë në të gjitha vendvotimet në veri, të cilët kanë mbështetur në mënyrë aktive komisionerët e vendvotimeve, veçanërisht gjatë fazës së numërimit.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Regjistrimi i votuesve në Kosovë është sistem pasiv. Lista e votuesve nxirret nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile që mirëmbahet nga Ministria e Brendshme⁴. KQZ mbanë përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe përditësimin e listës së votuesve, e cila përfshinë të gjithë qytetarët e Kosovës me të drejtë vote por nuk përmban votuesit të cilët kanë aplikuar me sukses për programin për votim jashtë Kosovës. Saktësia e listës së votuesve, megjithatë, mbetet e ulët për shkak të madh të personave të vdekur në Regjistrin Civil, edhe pse janë bërë përpjekje për të pastruar regjistrin që nga janari i këtij viti. Ky proces i pastrimit është duke vazhduar dhe numri i madh i personave të vdekur në Regjistrin Civil ende paraqet një shqetësim të madh për subjektet politike. Zyrat e Regjistrimit Civil gjenden në të gjitha komunat dhe ato duhet të regjistrojnë lindjet, vdekjet dhe

³ EOM ka vërejtur disa ekipe mobile për edukim të votuesve të KQZ në Partesh dhe Kamenicë. Për më shumë, vetëm KKZ në Glllogoc ka organizuar trajnim për votuesit që votojnë për herë të parë.

⁴ Regjistri Civil aktual bazohet në regjistrin e UNMIK-ut (Misioni Paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara) i cili është krijuar pas luftës. Personat që kanë marrë dokumentet e UNMIK-ut, dhe më vonë dokumentet e Kosovës, janë të përfshirë në regjistrin. Regjistri po ashtu përmban të dhëna biometrike dhe çdo qytetari i është caktuar një kod unik.

ndryshimet eventuale të adresës. Sidoqoftë, zyrat janë lidhur me bazën qendrore të të dhënave vetëm vitin e kaluar.

Ligji lejon që numri i vlerësuar prej 560,000 personave⁵ që nuk jetojnë në Kosovë dhe që ende janë të regjistruar në regjistrin civil, të jetë në listën e votuesve. Ky është një shqetësim i subjekteve politike të cilat kanë frikë se ky numër i madh i votuesve nga diaspora lë procesin të hapur për manipulime.

KQZ-ja shpalli një listë preliminare të votuesve me 1,786,929 votues. Kjo shifër përfshin votuesit e përfshirë si pasojë e Marrëveshjes së Brukselit⁶ (7,671 votues), ndërsa 3,334 votues janë larguar meqë ata kishin aplikuar me sukses në programin e votuesve jashtë Kosovës.

Votuesit kanë pasur mundësinë të ankohen për listën e votuesve prej datës 22 deri me 24 maj, në mënyrë që të korrigjohen pasaktësitë ose lëshimet. Megjithatë, EOM ka vërejtur se listat preliminare të votuesve nuk janë vënë në dispozicion për konsultime publike në të gjitha komunat gjatë periudhës për ankesa, siç parashihet me ligj. Sipas Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, periudha për ankesa është momenti i vetëm ku KQZ ka mundësinë për të përmirësuar cilësinë e listës së votuesve, duke larguar votuesit e vdekur sipas kërkesës së njerëzve. Kjo periudhë parashihet që të zgjasë 15 ditë, sipas Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, por në këto zgjedhje ajo ka zgjatur vetëm tre ditë, gjatë së cilës asnjë votues nuk është ankuar për listën. KQZ ka larguar 27,304 votues sepse ata kishin vdekur (20,192) ose për shkak se kishin hequr dorë nga shtetësia (7,112). Disa votues janë larguar si pasojë e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

KQZ certifikoi listën përfundimtare të votuesve më datën 28 maj me shumicë votash⁷; ajo përbëhet prej 1,782,454 votuesve. EOM ka vëzhguar shtypjen e listës përfundimtare të votuesve që është bërë në Pejë dhe paketimin e listave për çdo komunë, që ishte bërë si duhet dhe në kushte të mira sigurie.

Për shkak të pasaktësisë së sistemit të adresave, KQZ ka lejuar votuesit të ndryshojnë vendvotimet që u ishin caktuar atyre gjatë të ashtuquajturës periudhës së shërbimit për votues prej datës 14 deri më 24 maj. Gjithsej 6,275 votues kanë ndryshuar me sukses vendvotimet e tyre.

VII. VOTIMI JASHTË KOSOVËS

Votuesit me të drejtë vote të cilët përkohësisht jetojnë jashtë ose janë të zhvendosur nga Kosova kanë të drejtë të regjistrohen dhe të votojnë përmes postës. Periudhat e shkurtra në këto zgjedhje për regjistrim dhe votim – prej 13 deri më 19 maj respektivisht prej 27 maj deri më 6 qershor – kanë zvogëluar mundësitë për aplikim për votim jashtë Kosovës si dhe për tu ankuar për aplikacionet e refuzuara. Nga 29,754 aplikacione, janë hedhur vetëm 10,648 fletëvotime përmes votimit jashtë Kosovës. Partitë politike janë ankuar lidhur me manipulimet e pretenduara të votimit jashtë Kosovës dhe EU EOM ka vërejtur mungesë të garancive.

Kriteret gjithëpërfshirëse për të drejtën e votimi të rregullt aplikohen edhe për programin për votim jashtë Kosovës. Programi është menaxhuar nga KQZ, me ndihmën teknike nga OSBE e cila ka siguruar transportimin e dokumenteve zgjedhore prej dhe për në Serbi, për shkak të mungesës së komunikimit postar me Kosovën.

⁵ Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 vlerëson se 562,951 qytetarë që jetojnë jashtë Kosovës janë ende të regjistruar në Regjistrin Civil.

⁶ Si pasojë e dialogut Beograd-Prishtinë, këta persona janë përfshirë në listën e votuesve bazuar në vendbanimet e tyre në katër komunat veriore edhe pse nuk kanë shtetësi të Kosovës dhe asnjëherë nuk janë regjistruar në Regjistrin Civil.

⁷ Vendimi i KQZ-së 1150/2014 i datës 28 maj 2014. Anëtarët e KQZ-së që përfaqësojnë Vetëvendosjen dhe përfaqësuesi i komunitetit jo-shumicë serb votuan kundër certifikimit të listës së votuesve. Anëtari i KQZ-së nga Vetëvendosja nuk është pajtuar me përfshirjen në listën e votuesve të 7,671 qytetarëve serbë, si pasojë e Marrëveshjes së Brukselit. Për më shumë, ai ka qenë kundër përdorimit të kartelës së refugjatit si dokument që tregon të drejtën për të votuar. Në anën tjetër, përfaqësuesi i komunitetit jo-shumicë serb nuk është pajtuar me këtë numër meqë e ka konsideruar si të pasaktë.

Edhe pse udhëzimet gjithëpërfshirëse të dhëna nga KQZ-ja janë përmirësuar nga zgjedhjet e kaluara, votuesit jashtë Kosovës është dashur të aplikojnë për të marrë fletëvotimin duke paraqitur formularin e aplikacionit dhe dokumente si dëshmi për të drejtën e votimit dhe identitetit, në pajtim me ligjin. Megjithatë, aplikuesit e suksesshëm në zgjedhjet e kaluara nuk kishin nevojë prapë të marrin pakon e votimit, por vetëm të dëshmojnë identitetin.

Gjatë shtatë ditëve të parapara si periudhë e regjistrimit KQZ ka pranuar 29,754 aplikacione. Nga këto, 25,433 (ose 85%) ishin transportuar nga Serbia përmes ndihmës në transport të siguruar nga OSBE, i cili për herë të parë u bë në bashkëpunim me një delegacion të KQZ-së.

KQZ në rastin e parë ka pranuar gjithsej 16,569 aplikacione. KQZ ka angazhuar dhe ka trajnuar 300 punëtorë për të verifikuar vlefshmërinë e dokumenteve të përfshira në aplikacione. EOM nuk ka vëzhguar këtë fazë por shpreh disa shqetësime lidhur me saktësinë e procesit me të cilin është bërë vlerësimi i të gjitha aplikacioneve për vetëm tre ditë.

Sipas ligjit, aplikuesit e refuzuar mund të ankohen në PZAP në shkallën e parë dhe në Gjykatën Supreme në shkallën e dytë, por me kalendarin e shkurtuar zgjedhor për këto zgjedhje, periudha për të kundërshtuar vendimin e KQZ-së dhe periudha e votimit kanë përkuar me njëra-tjetrën. Afatet kohore kanë zvogëluar në masë të konsiderueshme mundësinë për tu ankuar në PZAP, i cili i ka marrë 9,172 parashtresa vetëm me datën 1 qershor dhe ka pranuar vetëm 206 prej tyre. Për më shumë, afati shumë i shkurtër kohor e ka bërë ankimin në Gjykatën Supreme të pamundshëm. Si pasojë, e drejta e votuesve për të kërkuar mjetin e fundit ligjor është cenuar.

Gjatë periudhës së votimit, KQZ ka marrë 15,951 vota me postë. Verifikimi i zarfeve prej jashtë Kosovës ka filluar në Ditën e Zgjedhjeve dhe është kryer brenda një jave. KQZ i ka pranuar 10,648 zarfe (68% e të gjitha zarfeve që i ka marrë). Nga këto, 8,551 ishin nga Serbia. Numri më i madh i zarfeve të refuzuara (3,223 ose 64.8% e të gjitha zarfeve të refuzuara) kishin të bënin me votuesit të cilët nuk kishin ofruar kopjen e kërkuar të dokumentit identifikues në zarf. Për më shumë, 551 zarfe janë refuzuar sepse votuesit nuk kanë aplikuar gjatë periudhës së regjistrimit ose aplikacionet e tyre ishin refuzuar. EU EOM ka vëzhguar tërë këtë fazë dhe mund të konfirmojë se procedurat janë ndjekur me saktësi.

Gjatë numërimit të fletëvotimeve nga jashtë Kosovës vëzhguesit e partive politike janë larguar nga QNR në shenjë proteste duke pretenduar se fletëvotimet e hedhura për Listën Serbe e ishin të shënuara në mënyrë identike dhe me pesë votat e njëjta preferenciale për kandidatët. Aplikuesit e suksesshëm nga jashtë Kosovës kanë pasur mundësinë të shkarkojnë fletëvotimin nga faqja e internetit e KQZ-së dhe ta dërgojnë duke përdorur një zarf të zakonshëm, në mënyrë që të respektojnë afatin e shkurtër kohor. Stafit të QNR-së i lejohet të refuzojë zarfin e fshehtë nëse ai nuk përmban asnjë fletëvotim ose nëse përmban më shumë se një fletëvotim, por nuk është e mundur të refuzohet fletëvotimi nëse vërtetësia ose integriteti i tij është i dyshimtë. Mungesa e garancive për integritetin e fletëvotimit në këtë fazë të procesit të votimit jashtë Kosovës nuk garanton se votuesi ka plotësuar fletëvotimin lirshëm dhe pa ndërhyrje dhe mbi të gjitha, mund të çojë në manipulime që nuk mund të demonstrohen lehtë nga QNR ose PZAP. Stafi i QNR ka kryer numërimin e votave nga jashtë Kosovës brenda një dite.

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE DHE CERTIFIKIMI

Kriteret e përgjithshme për të qenë kandidat në zgjedhje janë përcaktuar në LZP dhe janë gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese. Çdo person emri i të cilit gjendet në Listën e Votuesve ka të drejtë të regjistrohet si kandidat. LZP e kufizon këtë të drejtë duke iu referuar kategorive të caktuara të personave të cilët nuk kanë të drejtë të bëhen kandidatë. Sa i përket kandidatëve të përfshirë në procedura penale, ligji respekton supozimin e pafajësisë deri sa personi nuk shpallet fajtor nga gjykata. Veç kësaj, askush që tashmë është anëtar i ndonjë organi tjetër të zgjedhur

legjislativ (siç është Kuvendi Komunal) nuk mund të fitoj ulëse në Kuvend, deri sa ai/ajo të heq dorë nga mandati tjetër.

Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike brenda KQZ-së merret me regjistrimin e partive politike dhe kandidatëve dhe me certifikimin e tyre. Ajo ka për obligim jo vetëm të regjistrojë por edhe të mirëmbajë regjistrin e partive politike si dhe kufijtë e shpenzimeve të fushatës dhe deklaratat financiare. Partitë e regjistruara politike certifikohen automatikisht në kohën e zgjedhjeve përveç nëse ato shprehin dëshirën e tyre për t'u certifikuar.

Regjistrimi i kandidatëve është bërë në mënyrë gjithëpërfshirëse. Vetëm një kandidati nga një subjekt politik serb që ishte edhe deputet i Kuvendit të Serbisë i ishte tërhequr vërejtja nga KQZ se nuk ishte i pranueshëm. Subjekti kishte zëvendësuar kandidatin, por kishte shfaqur pakënaqësinë e saj duke paraqitur ankesë, e cila në fund është refuzuar. KQZ ka certifikuar 30 subjekte politike: 18 parti politike, shtatë iniciativa qytetare, katër koalicione dhe një kandidat të pavarur. Në momentin e regjistrimit dhe certifikimit, subjektet politike kanë mundësinë që të deklarohen se përfaqësojnë një nga komunitetet jo-shumicë, që u jep të drejtën të garojnë për ulëset e garantuara në Kuvend. Në mesin e subjekteve të certifikuara politike 21 prej tyre përfaqësonin komunitetet jo-shumicë: pesë serbët e Kosovës, gjashtë boshnjakët, dy turqit, dy goranët, dy romët, dy ashkalinjtë dhe dy egjiptianët.

IX. AMBIENTI I FUSHATËS

Vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme pas 30 ditësh kufizoi fushatën zyrtare në vetëm dhjetë ditë. Megjithatë, aktivitetet e fushatës nga subjektet kryesore politike u vërejtën që nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve me 8 maj, me përjashtim të veriut.

Gjatë fushatës zyrtare EU EOM ka vërejtur numër të madh tubimesh dhe ngjarjesh publike që mbaheshin në komunat e Kosovës. Në pjesën më të madhe të Kosovës, fushata u zhvillua në atmosferë të qetë, pa incidente ose dhunë dhe subjektet politike dhe votuesit ushtruan lirinë e tubimit, shprehjes dhe lëvizjes. Kandidatët zhvilluan fushatë derë-më-derë dhe takime të vogla, përveç shpërndarjes së fletushkave ose kartëvizitave, ndërsa subjektet kryesore politike po ashtu përdorën mjete më të shtrenjta: billborde dhe tubime të mëdha, por para së gjithash, mbulimin me pagesë të aktivitetëve të tyre në kanalet kryesore televizive, të plotësuar me përdorim dinamik të platformave të rrjeteve sociale.

Aplikimi i sistemit të ulëseve të garantuara ka qenë çështja kryesore e diskutuar nga liderët politikë serbë dhe akterët e shoqërisë civile gjatë periudhës para Ditës së Zgjedhjeve. Në këtë kontekst, me datën 28 maj katër kryetarët e komunave veriore vendosën të pezullojnë aktivitetet zgjedhore dhe kërcënuan me bojkotim të zgjedhjeve duke cituar vendimin e KQZ-së lidhur me përbërjen e KVV-ve dhe përdorimin e fletëvotimeve që mbanin emblemën e Kosovës. Lista Serbe ngriu fushatën e saj në të gjitha komunat me shumicë serbe. Ndërkohë, kundërshtari i saj kryesor serb (PDS) dhe subjektet e tjera politike jo-shumicë bënë fushatë aktive në zonat me shumicë serbe në jug.

Më datë 3 qershor, pas intervenimit të Kryeministrit serb dhe thirrjes për pjesëmarrje të serbëve të Kosovës, Lista Serbe filloi të bëjë fushatë intensive në zonat me shumicë serbe në jug, me paraqitje në media, me fushatë derë-më-derë dhe me tubime të shumta. Në veri, liderët e Listës Serbe më në fund u pajtuan që mos të bojkotojnë zgjedhjet, por gjatë tri ditëve të fundit të periudhës nuk u bë fushatë. Pezullimi i aktivitetëve zgjedhore dhe kërcënimi për bojkotim dekurajoi subjektet më të vogla politike të serbëve dhe të atyre jo-shumicë të zhvillojnë fushatë të dukshme në veri. Kjo në masë të dukshme ka ndikuar në të drejtën e votuesve për t'u informuar mbi kandidatët dhe programet e tyre, dhe se si të shprehin zgjedhjen e tyre në fletëvotim, informacione që zakonisht u ofrua nga subjektet politike.

PDK, AKR, AAK, Vetëvendosje dhe LDK të gjitha zhvilluan fushatë aktive gjatë periudhës para fushatës, përfshirë edhe përmes billbordeve, mediave dhe tubimeve. Garuesi që është parë më së shumti para fillimit zyrtar të fushatës, veçanërisht në media, ishte Kryeministri dhe lideri i koalicionit të udhëhequr nga PDK, Hashim Thaçi. Vetëvendosje kishte paraqitur ankesë në PZAP, duke akuzuar atë për shpërdorim të fondeve publike për zhvillim të fushatës, edhe subjektet e tjera kanë ngritur shqetësime lidhur me atë që ata kanë konsideruar si mbulim të tepërt të aktiviteteve të tij nga transmetuesi publik RTK. Subjektet më të vogla politike janë ankuar për mungesë kontrolli mbi aktivitetet e fushatës para fillimit zyrtar të saj. Koha e shkurtër e fushatës zyrtare kufizoi kohën e transmetimit pa pagesë, mbulimin e rregulluar në media dhe kohën për aktivitete të fushatës, çka veçanërisht i ka prekur partitë më të vogla.

Kodi i mirësjelljes për subjektet politike i përcaktuar nga Rregulla Zgjedhore 11/2013 shprehimisht ndalon përdorimin e gjuhën nxitëse dhe inkurajimin e dhunës. Në përgjithësi, toni i garuesve, siç është vërejtur nga EU EOM, është vlerësuar si i moderuar dhe ndonëse në ditët e fundit disa parti iu kthyen kthyer temave nacionaliste, si dhe akuzave për korrupsion dhe krim të organizuar, ky ton nuk u përkeqësua aq shumë. Kandidatët janë fokusuar në çështje si zhvillimi ekonomik, punësimi dhe investimet. Sidoqoftë, fushata bazohet në masë të madhe në personalitetet e liderëve.

Përkundër kuotës prej 30% për kandidatet femra në lista, femrat ishin të nën-përfaqësuar gjatë fushatës. Partitë politike vazhdojnë të dominohen nga meshkujt. Disa kandidatë [femra] të mirënjohura të dy partive kryesore ishin përjashtim. Gratë kanë folur rrallë gjatë tubimeve të fushatës, mesazhet nuk u drejtoheshin në mënyrë grave dhe pjesëmarrja e grave në tubime ka qenë e ulët. Kandidatet femra siç raportohet i ishin nënshtruar abuzimit në internet gjatë fushatës.

Subjektet politike ua drejtuan mesazhet e tyre vetëm komuniteteve të tyre, ekskluzivisht në një gjuhë, dhe nuk u përpoqën tu drejtohen votuesve të tjerë. Garuesit nga komunitetet jo-shumicë kanë bërë fushatë ekskluzivisht në zona ku kanë pasur popullatë të konsiderueshme (serbët më së shumti në 10 komunat me shumicë serbe, goranët në Dragash, ndërsa turqit, boshnjakët, romët, egjiptianët dhe ashkalinjtë në disa rajone).

Presioni mbi punëtorët dhe votuesit, blerja e votave, dhe shpërdorimi i pozitës ose resurseve publike janë shkelje të rregullave zgjedhore siç parashihet me ligj dhe përbëjnë shkelje zgjedhore të sanksionuara nga PZAP. Disa subjekte politike u kanë raportuar vëzhguesve të EU EOM se punëtorët e sektorit publik (veçanërisht mësuesit, punëtorët social dhe shëndetësor) janë udhëzuar të marrin pjesë në tubime, dhe të votojnë për partinë që kishte pushtetin në komunë, në shumicën e rasteve PDK, por po ashtu për Listën Serbe në zona të ndryshme me shumicë serbe. Pretendimet për presion të ngjashëm mbi punëtorët e një biznesi privat në pronësi të një kandidati janë konsideruar si të besueshme nga vëzhguesit në Pejë dhe Kamenicë. EU EOM i ka vlerësuar si të besueshme pretendimet e ndryshme për presion të ushtruar mbi punëtorët e sektorit publik për të dal për të votuar në komunat veriore të Zubin Potokut dhe Leposaviqit.

A. Financimi i fushatës

Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji mbi Financimin e Partive Politike dhe rregullat e KQZ-së mbi financimin e fushatës për subjektet politike përcaktojnë kufijtë e shpenzimeve dhe obligimet për deklarimin e tyre, mekanizmat e auditimit dhe gjobat në rast të shkeljeve. Megjithatë, këto rregullore aplikohen vetëm gjatë periudhës së fushatës zyrtare. Meqë nuk ka ndonjë rregull specifike në kornizën ligjore për periudhën që i paraprin këtyre dhjetë ditëve, të gjithë akterët kryesorë që kanë kapacitet më të madh financiar (domethënë koalicioni i udhëhequr nga PDK, LDK, AAK, AKR) kanë shpenzuar një pjesë të konsiderueshme të mjeteve të tyre për fushatë gjatë periudhës para fushatës, duke mbajtur tubime të mëdha, duke vendosur billborde të shumta, dhe duke blerë hapësirë televizive pa u përballur me ndonjë mekanizëm për kontrollin e shpenzimeve ose me gjoba.

Ligji mbi financimin e partive politike (03/L-174) parasheh ndarjen e fondeve publike për aktivitetet e rregullta të subjekteve politike, e kushtëzuar kjo me përfaqësimin e tyre në Kuvend dhe sipas numrin të ulëseve të tyre. Ata marrin këtë pjesë të buxhetit vjetor në disa këste, ku i fundit kishte arritur në prill, para shpalljes së zgjedhjeve. Ligji i lejon Kuvendit që tu ndaj partive politike fonde shtesë nga buxheti për zgjedhje. Për zgjedhje parlamentare, 90% e këtyre fondeve janë ndarë në bazë të numrit të ulëseve të fituara nga subjekti në zgjedhjet paraprake për Kuvend, dhe pjesa tjetër prej 10% i është ndarë subjekteve politike të certifikuara për këto zgjedhje. Për këto zgjedhje të parakohshme parlamentare subjekteve politike nuk u janë ndarë para shtesë. Si rezultat, partitë që nuk ishin tashmë të përfaqësuara në Kuvend nuk kanë përfituar nga asnjë fond shtetëror.

Ligjet dhe rregulloret mbi financimin e fushatës përcaktojnë kufijtë e shpenzimeve të subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore. Sipas LZP-së, një subjekt politik që merr pjesë në zgjedhje nuk duhet të tejkalojë një shumë të caktuar të shpenzimeve për fushatë, e cila përkufizohet nga KQZ jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve. Më 12 maj 2014 KQZ ka marrë vendim duke përcaktuar shumën maksimale prej 893,463.50 euro, bazuar në Rregullën Zgjedhore 12/2013, e cila kufizon shpenzimet e fushatës për zgjedhje parlamentare të Kosovës në 0.5 euro për një votues të regjistruar, dhe numrin e votuesve të regjistruar në zgjedhjet e vitit 2014, d.m.th. 1,786,927. Ligji mbi financimin e partive politike (03/L-174) po ashtu cakton kufizime të qarta për donacionet e pranuar nga subjektet politike: atyre u lejohet të pranojnë 2000 euro në vit nga një person fizik dhe 10,000 euro në vit nga një person juridik.

Në pajtim me Rregullën Zgjedhore 12/2013, çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje është i obliguar të paraqes, jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve, raportin e deklaramit financiar të fushatës i cili mbulon periudhën prej 90 ditësh deri në ditën e zgjedhjeve. Meqë këto zgjedhje të parakohshme janë shpallur vetëm një muaj para Ditës së Zgjedhjeve, periudha që duhet mbuluar në raport është shkurtuar në 30 ditë.

Subjektet politike i dorëzojnë raportin e deklaramit financiar të fushatës zyrës së KQZ-së që është përgjegjëse të monitorojë se sa i respektojnë ato rregullat, Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), e cila pastaj kryen auditimin. Për qëllime të auditimit të fushatës subjekteve politike u kërkohet që në raportet e tyre të deklaramit financiar të japin informacione për të gjitha të ardhurat, përfshirë datën e tyre dhe burimin, dhe mbi të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e fushatës të bëra gjatë kësaj periudhe. Për më tepër, ata duhet tu ofrojnë auditorëve qasje të plotë në të dhënat e tyre financiare. Megjithatë, në praktikë auditorët nuk kontrollojnë plotësinë e të dhënave, d.m.th. nëse në fakt të gjitha shpenzimet e fushatës dhe të gjitha fondet e pranuar nga subjektet politike janë paraqitur në raportet e dorëzuara. Fushëveprimi i kufizuar i këtij kontrolli financiar u ofron hapësirë subjekteve politike të shpenzojnë mbi kufizimet e përcaktuara me ligj, dhe ka gjasa që të mbajë donacionet e paregjistruara larg nga kontrolli i detajuar. Si rezultat, dispozitat ligjore që kanë për qëllim caktimin e një kufiri të shpenzimeve të fushatës së subjekteve politike janë joefektive.

X. AMBIENTI I MEDIAVE

A. Peizazhi i mediave

Peizazhi mediatik në Kosovë ka pasur zhvillim të hovshëm gjatë 15 viteve të fundit dhe sot Kosova ka 21 TV kanale televizive tokësore, 83 radiostacione, 49 TV kanale kabllorë⁸ dhe tetë gazeta ditore që paraqesin një larmi të linjave redaktuese dhe të pikëpamjeve politike. Ekzistojnë katër kanale televizive publike dhe dy kanale publike të radios.

⁸ Lista e mediave elektronike të licencuara është marrë nga Komisioni i Pavarur për Media, statusi në qershor 2014.

Të gjitha gazetat dhe shumica e kanaleve televizive tokësore (15 prej 21 sosh) dhe atyre kabllore (47 prej 49 sosh) transmetojnë në gjuhën shqipe. Të tjerat transmetojnë në serbisht dhe një prej tyre në turqisht. Gjuhët e pakicave përdoren në shkallë më të gjerë nga radio-transmetuesit ku 49 radiostacione transmetojnë në gjuhën shqipe, 25 në gjuhën serbe, një prej tyre edhe në shqip edhe në serbisht dhe të tjerat në gjuhët e komuniteteve të tjera (në gjuhën turke, boshnjake, gorane, rome). Vetëm tre kanale televizive dhe tre radiostacione kanë mbulesë në tërë Kosovën.

Mediat publike janë pjesë e Radio Televizionit të Kosovës (RTK). Besohet gjerësisht se kanali RTK1 është burimi më i rëndësishëm për votuesit shqiptarë të Kosovës. Konkurrentët e tij kryesor përfshijnë kanalet tokësore private KTV dhe TV21 që mbulojnë tërë Kosovën si dhe kanali televiziv kabllor Klan Kosova që po ashtu mbulon tërë territorin e Kosovës. Media e vetme publike që transmeton në gjuhën serbe është kanali televiziv kabllor RTK2, i cili është duke funksionuar për pothuaj një vit.

Tregu i mediave të shkruara karakterizohet me tirazh të kufizuar ku asnjë gazetë nuk shitet më shumë se 8,000 kopje në ditë. Në anën tjetër, besohet se mediat elektronike po shënojnë popullaritet në rritje, ku faqet kryesore të lajmeve në internet publikojnë në shqip. Numri i blogjeve politike dhe aktiviteteve të ndërlidhura me politikën në mediat sociale po ashtu është në rritje.

Mediat e transmetuara mbikëqyren nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), organ kushtetues që mbikëqyrë dhënien dhe mbikëqyrjen e licencave. KPM filloi së funksionuari përsëri në prill të vitit 2014 pasi Kuvendi caktoi katër anëtarë të rinj në Këshillin e tij shtatë anëtarësh. Pothuajse të gjithë bashkëbiseduesit nga mediat kanë shprehur besimin e tyre në paanshmërinë e organit. Megjithatë duhet të theksohet se Këshilli nuk ka mbajtur asnjë takim gjatë fushatës zgjedhore dhe është takuar vetëm pas ditës së zgjedhjeve.

Gjatë procesit të vëzhguar zgjedhor liria e mediave në përgjithësi është respektuar. Nuk është raportuar për gazetarë të përfshirë në incidente të mëdha të ndërlidhura me zgjedhjet dhe shumica e bashkëbiseduesve nga mediat kanë thënë se kanë qenë të lirë të kryejnë punën e tyre.

B. Korniza ligjore

Kushtetuta parasheh ‘liri dhe pluralizëm të mediave’, garanton të drejtën për qasje në dokumente publike dhe ndalon censurimin. Baza ligjore lidhur me mediat gjatë procesit zgjedhor rrjedh nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (2012), Ligji për Komisionin e Pavarur për Media (2008), dhe ligjin sekondar përfshirë Udhëzimin e KPM mbi zbatimin e Kapitullit VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të datës 23 maj 2014 dhe Rregulloren KPM-2013/03 të KPM-së mbi Komunikimet Komerciale Audio-vizuale të datës 28 maj 2013.

LZP kërkon që të gjitha mediat të sigurojnë mbulim të ‘drejtë dhe të barabartë’ me lajme për të gjitha subjektet politike të certifikuara gjatë fushatës dhe veçanërisht i obligon mediat transmetuese të garantojnë ‘qasje të drejtë dhe të barabartë në programet e diskutimeve dhe debateve politike’. I njëjti ligj po ashtu obligon të gjitha mediat që transmetojnë spote reklamuese politike që të ofrojnë hapësirë të barabartë të transmetimit pa pagesë për të gjithë garuesit. U përket mediave individuale të vendosin se kur do të ofrojnë hapësirën pa pagesë dhe cilën metodologji do të aplikojnë në llogaritjen e saktë të kohëzgjatjes. Ndërsa nuk ka kufizime mbi spotet reklamuese politike, çmimi i kërkuar nuk duhet të tejkalojë tarifën më të ulët të përdorur për të njëjtën ‘kohë dhe ditë të javës’ në gjashtë muajt e fundit.

KPM ka për detyrë të monitorojë respektimin e dispozitave të sipërpërmendura nga mediat transmetuese. Ai po ashtu është kompetent të miratoj akte të legjislacionit sekondar dhe të gjobisë mediat të cilat nuk i respektojnë rregullat e licencës.

Sipas Rregullores së KPM-së KPM-2013/03 mediave nuk u lejohej të transmetojnë spote reklamuese politike para periudhës zyrtare të fushatës. Gjatë fushatës, rregullorja lejon një formë tjetër të reklamimit: mbulimin e sponzoruar të aktiviteteve zgjedhore. Sipas Rregullores KPM-2013/03 mbulimi i sponzoruar mund të transmetohet gjatë fushatës pa kufi me kusht që të jetë i shënuar si i tillë. Kjo ka çuar në blerje masive të hapësirës transmetuese në kohën e shikueshmërisë së lartë gjatë fushatës, me çmime të pabarabarta, dhe si pasojë ka kufizuar barazinë e garuesve gjatë procesit zgjedhor.

Edhe pse KPM nuk ka marrë asnjë ankesë, ai *ex officio* ka identifikuar disa shkelje të rregullave të tij. Përveç tjerash, pesë kanale televizive kanë marrë vërejtje për transmetimin e spoteve reklamuese politike dhe deklaratave të partive politike para fillimit zyrtar të fushatës. Top Kosova Radio ka marrë një vërejtje pasi drejtoresha e saj Margarita Kadriu i është bashkuar PDK-së dhe u bë zëvendëse e Hashim Thaçit në parti, praktikë e ndaluar me nenin 22.3.1 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media. Më vonë, gjatë fushatës, KPM ua tërhoqi vërejtjen gjashtë stacioneve televizive për transmetim me pagesë të reklamave të paidentifikuara dhe dy të tjerave për thyerjen e heshtjes zgjedhore. Deri në 75 media transmetuese nuk ia kanë paraqitur me kohë KPM-së raportet e tyre të obligueshme për spotet reklamuese me pagesë dhe atyre pa pagesë.

C. Gjetjet nga monitorimi i mediave

Shkurtimi i fushatës nga 30 në 10 ditë ka pasur ndikim negativ në mbulimin mediatik në dy aspekte kryesore: partitë përdorën mjetet e tyre financiare për të blerë në mënyrë masive programe të sponzoruara, e cila si rezultat ka kufizuar sasinë e përgjithshme të mbulimit jo-komercial të fushatës, dhe ato po ashtu zhvilluan aktivitete tipike të fushatës para periudhës zyrtare të fushatës. Kjo e fundit krijoi një situatë ku fushata *de facto* ishte shumë më e gjatë se ajo zyrtare dhe pjesërisht u zhvillua pa mekanizma standard ligjor që garantojnë mbulim të barabartë, paanshmëri të mediave dhe mbrojtje të akterëve të vegjël politik.

Njësia për Monitorim të Mediave⁹ ka konfirmuar se fushata në media *de facto* ka filluar para periudhës së fushatës zyrtare. Analiza e EU EOM për periudhën para fushatës ka gjetur se që të gjashtë partitë kryesore të shqiptareve të Kosovës ishin mbuluar në edicionet e lajmeve të mbrëmjes në RTK dhe totali i informacioneve lidhur me aktivitetet e partive gjatë ditëve të fundit ka arritur në gati 20 minuta në ditë, edhe pse PDK-së¹⁰ i është dhënë më shumë hapësirë. Shumica e aktiviteteve të mbuluara të partive ishin *de facto* aktivitete të fushatës – partitë dhanë premtime zgjedhore dhe Kryeministri përdori gjerësisht emrin e koalicionit të tij zgjedhor, Misioni i Ri. EU EOM beson se kjo praktikë është edhe një rezultat tjetër i shkurtimit të periudhës së fushatës: gjatë një pjese të madhe të asaj që *de facto* ishte fushatë zgjedhore, nuk janë aplikuar dispozitat ligjore për barazi të subjekteve politike.

Gjatë periudhës së fushatës zyrtare mbulimi i sponzoruar në televizion u përdor si mjet i fushatës në një nivel i cili, siç thanë shumë bashkëbisedues, nuk ishte parë në zgjedhjet e mëhershme. Ai kryesisht përbëhej nga transmetimet e sponzoruara të tubimeve të partive politike dhe fjalimeve të liderëve partiakë. Kjo praktikë ka rritur në masë të konsiderueshme përqindjen e tërë hapësirës me pagesë në katër kanalet e vëzhguara televizive në gjuhën shqipe. Derisa spotet reklamuese politike ishin të shpërndara pothuajse në mënyrë të barabartë në të katër kanalet, qasja e tyre ndaj

⁹ Ekipi ka monitoruar pesë kanale televizive (RTK1, RTK2, Klan Kosova, KTV, TV21), dy radiostacione (Radio Kosova 1, Radio KIM), katër gazeta (*Koha Ditore*, *Kosova Sot*, *Tribuna* dhe *Zëri*) dhe edicionet kryesore të lajmeve në dy media serbe të Kosovës (TV Most, TV Puls). Përmbajtja e të gjitha mediave është monitoruar gjatë tërë periudhës së fushatës prej 28 majit deri me 6 qershor, kanalet televizive prej orës 18:00 deri në 24:00 dhe radiostacionet prej orës 17:00 deri në 20:00 çdo ditë.

¹⁰ PDK 34%, LDK 21%, AAK 15%, Vetëvendosje 13%, AKR 9%, Nisma 6%. Të dhënat për të gjitha lajmet mbi partitë politike dhe liderët e tyre janë transmetuar në të gjitha edicionet e *Lajmeve* (programi i lajmeve i orës 19:30) prej 8 deri me 27 maj.

programeve të sponzoruar ka dalluar në masë të madhe. Kjo praktikë ka qenë e dukshme sidomos në KTV, e cila ka transmetuar mesatarisht 2 orë e 30 minuta të programit të sponzoruar në ditë dhe në këtë mënyrë ka kufizuar në masë të madhe kohën e mbulimit jo-komercial të zgjedhjeve. Në një masë më të vogël, por të rëndësishme, kjo praktikë është përdorur edhe nga Klan Kosova dhe RTK1, ku programet e sponzoruar kanë arritur në 25%, respektivisht 11% të hapësirës në kohën e shikueshmërisë së lartë. Vetëm TV21 ka kufizuar programet e sponzoruar në më pak se 5% të hapësirës në kohën e shikueshmërisë së lartë. Pjesa më e madhe e kohës së transmetimit me pagesë (kombinim i spoteve reklamuese politike dhe mbulimit të sponzoruar) në katër kanalet e vëzhguara televizive në gjuhën shqipe është blerë nga PDK (32%), pasuar nga LDK (20%), AAK, Vetëvendosje dhe AKR (13-15% secila) dhe Nisma (6%)¹¹. Kanalet televizive e shfrytëzuan një zbrazëti ligjore për të aplikuar çmime 'të negociuara' për mbulimin e sponzoruar, praktikë e cila duket se nuk është në pajtim me rregullën e përgjithshme të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, e cila përcakton trajtim të barabartë të konkurrentëve politik.

Megjithatë, në programet e tyre të lajmeve shumica e mediave ofruan hapësirë të barabartë për të gjithë garuesit nga komunitetet e tyre përkatëse duke aplikuar ose barazi proporcionale (RTK1, Radio Kosova) ose barazi të rreptë (TV21, Klan Kosova), të dyja këto në pajtim me Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venedikut. Televizioni publik RTK1 u ka dhënë hapësirë më të madhe të mbulimit kandidatëve të PDK-së (25%) dhe LDK-së (21%). Katër subjektet e tjera parlamentare të shqiptarëve të Kosovës (AKR, AAK, Vetëvendosje dhe Nisma) po ashtu u mbuluan në shkallë të gjerë. Dukshmëria e fushatës së PDK-së ka qenë paksa më e lartë në edicionet kryesore të lajmeve në RTK me 28% për PDK-në dhe 21% për LDK-në. Kanali publik Radio Kosova 1 pati një mbulim të ngjashëm të fushatës duke trajtuar PDK-në dhe LDK-në si garues kryesor dhe duke u dedikuar më shumë hapësirë atyre se sa partive të tjera parlamentare të shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, ajo mbuloi në masë të gjerë aktivitetet e qeverisë, që e bëri PDK-në më të dukshme se LDK-në.

Mbulimi në lajme në kanalet private TV21 dhe Klan Kosova ka qenë i balancuar edhe pse ky i fundit u ka dhënë më pak hapësirë AKR-së dhe Nisma-s. Mediat private që i takojnë Grupit Koha (kanali KTV dhe gazetës *Koha Ditore*) kanë pasur qëndrim të qartë negativ ndaj PDK-së. Edhe pse KTV u ka dhënë pothuajse hapësirë të barabartë garuesve kryesorë, ajo ka qenë dukshëm më kritike ndaj PDK-së se sa ndaj ndonjë partie tjetër të shqiptarëve të Kosovës. Ajo gjithashtu i ka dedikuar një sasi të madhe lajmesh për të mbuluar në mënyrë negative aktivitetet e qeverisë. Si rezultat, shumica e mbulesës që i ka bërë PDK-së dhe anëtarëve të saj ka qenë me ton negativ, për dallim nga mediat e tjera të cilat në përgjithësi kanë mbuluar fushatën e të gjitha partive nga pozita neutrale.

RTK1 dhe TV21 në përgjithësi u kanë dhënë subjekteve politike kundërshtare mundësi të barabartë për të përdorur fjalime të drejtpërdrejta në edicionet e lajmeve, debate, intervista dhe programe të tjera jo-komerciale. Përqindja e kohës së partive në tërë hapësirën e fjalimeve të drejtpërdrejta në RTK1 është sjell prej 14 deri 18%, në TV21 prej 12 deri 21%. Kandidatët e Nismës kanë qenë në masë të madhe të nën-përfaqësuar në Klan Kosova. Në KTV, adresimi i drejtpërdrejtë i është dhënë më së shumti Vetëvendosjes dhe LDK-së, me pak adresime të drejtpërdrejta nga përfaqësuesit e PDK-së. Të katër kanalet e vëzhguara televizive të shqiptarëve të Kosovës kanë organizuar debate ku – në të shumtën e rasteve – kanë marrë pjesë gjashtë partitë parlamentare shqiptare të Kosovës.

Lista Serbe kryesisht është mbuluar më shumë në edicionet e lajmeve të medias publike RTK2 dhe atyre private serbe ndonëse edhe rivali i saj kryesor PDS është mbuluar mjaft gjerësisht. Përgjithësisht bën TV Most i cili pothuajse ekskluzivisht ka mbuluar aktivitetet e Listës Serbe. RTK2 i ka dhënë PDS-së dhe subjektit tjetër serb, PDP-së, më shumë hapësirë në debatet e saj, një fakt që mund të shpjegohet me tërheqjen e pjesshme të Listës Serbe nga fushata.

¹¹ Praktika e shitjes së hapësirës transmetuese ose hapësirës për mbulim të sponzoruar nuk është vërejtur as në radiostacionet e vëzhguara e as në kanalin televiziv në gjuhën serbe RTK2.

Për dallim nga mediat transmetuese, gazetatat në të shumtën e rasteve kanë vijë të qartë redaktuese. *Koha Ditore* ka shfaqur njëanshmëri kundër PDK-së, ndërsa *Kosova Sot* ishte e njëanshme kundër LDK-së. *Tribuna* i ka dhënë AKR-së pothuajse të njëjtën hapësirë sa të dytës dhe të tretës, PDK-së dhe LDK-së së bashku, duke bërë fushatën e AKR-së shumë të dukshme. Raportimi nga *Zëri* dukej se ishte më i balancuar edhe pse gazeta ishte mjaft kritike ndaj PDK-së.

Mbulimi i kandidateve femra ishte shumë i ulët në edicionet e lajmeve të mediave transmetuese. Pjesërisht, kjo mund të reflektojë strategjitë e fushatave të partive politike. Kjo është sjell në mes të 4 dhe 15% ku RTK1 ishte dukshëm me shkallën më të ultë (4.5%). Disa media janë munduar të gjejnë më shumë baraspeshë në mbulimin e kandidateve femra duke u ofruar mundësinë të marrin pjesë në debate. Mes tjerash kjo ka qenë praktikë e kanalit Klan Kosova dhe TV21.

Në përgjithësi, të gjitha mediat në Kosovë janë përmbajtur nga mesazhet nxitëse edhe pse shumë prej tyre kanë kufizuar raportimin në komunitetet e tyre. Debatet në mes të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike praktikisht nuk kanë ekzistuar. Vetëm TV21 i ka thënë EU EOM se janë munduar të përfshijnë Listën Serbe në debate me partitë politike të shqiptarëve të Kosovës. Kanalet e tjera televizive kanë argumentuar se ose përkthimi do të ishte shumë problematik ose se “serbët kanë televizionin e tyre”. EU EOM beson se raportimi në vija etnike ka kufizuar mundësinë e votuesve për t’u informuar drejtë lidhur me aktivitetet e fushatës e veçanërisht ka ndikuar në komunitetet jo-shqiptare dhe jo-serbe të cilët nuk kanë qasje në media në gjuhën e tyre që transmetojnë në tërë Kosovën.

XI. DREJTËSIA ZGJEDHORE DHE ZBATIMI I TË DREJTAVE ZGJEDHORE

Pas pretendimeve për shkelje të të drejtave zgjedhore gjatë Zgjedhjeve të Përgjithshme të vitit 2010, në Kodin e ri Penal të Kosovës, që është në fuqi nga 1 janari 2013, seksioni që ka të bëjë me veprat penale kundër të drejtave zgjedhore ka ndryshuar në thelb. Numri i krimeve është rritur prej gjashtë në dhjetë. Tani ai përfshin shkeljen e të drejtës për të kandiduar, kanosjen e kandidatit, parandalimin e ushtrimit të së drejtës për të votuar, cenimin e përcaktimit të lirë të votuesve, shpërdorimin nga zyrtarët, dhënien ose marrjen e ryshfetit në lidhje me votimin, keqpërdorimin e të drejtës së votimit, cenimin e fshehtësisë së votimit, pengimin e procesit të votimit, falsifikimin e rezultateve të votimit dhe asgjësimin e dokumenteve të votimit. Dënimet e parapara për secilin krim po ashtu janë rritur. Krimet zgjedhore mund të ndëshkohen me gjobë dhe me burgim prej gjashtë deri në pesë vite. Dënimet më të larta parashihen për zyrtarët e zgjedhjeve. Edhe pse ndëshkimet janë të larta, ato kanë për qëllim dekurajimin e mëtejshëm të mashtrimeve elektorale.

Para Ditës së Zgjedhjeve është krijuar një bashkëpunim formal në mes të gjyqësorit të Kosovës, policisë, Këshillit Prokurorial, KQZ-së dhe PZAP-së. Ata po ashtu kanë organizuar ngjarje për zyrtarët e zgjedhjeve dhe anëtarët e subjekteve politike për rritje të vetëdijesimit lidhur me ndryshimet në Kodin Penal.

Në Ditën e Zgjedhjeve, policia dhe Koordinatori Kombëtar për Zgjedhje brenda Zyrës së Kryeprokurorit ka shpërndarë deri në 300 prokurorë. Kanë qenë 13 raste të hapura ku janë përfshirë 23 individë. Shumica e rasteve kanë pasur të bëjnë me pengim të procesit të votimit dhe parandalim në ushtrimin e të drejtës për të votuar. Operacioni duket se ka pasur efekt të zmbarsjes i cili ka dekurajuar shkeljet e rregullave zgjedhore. Numri i pretendimeve për mashtrim është rritur krahasuar me zgjedhjet e përgjithshme të kaluara. Rastet e hapura janë trajtuar me prioritet dhe në mënyrë më efikase. Përfaqësuesit e subjekteve politike, menaxherët e organeve zgjedhore, si dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë kanë vlerësuar realizimin e bashkëpunimit si shumë pozitiv. EU EOM ka vërejtur një vetëdijesim të rritur për pasojat potenciale në rast të shkeljes së kodit penal lidhur me zgjedhjet.

A. Parashtresat dhe ankesat

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i pavarur i përbërë nga gjyqtarët që është përgjegjës për të vendosur mbi ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të procesit zgjedhor dhe ankesat kundër vendimeve të KQZ-së. Paneli përbëhet prej dhjetë gjyqtarëve, përfshirë kryesuesin. Kuvendi i Kosovës ka ndryshuar Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në tetor të vitit 2010, duke bërë ndryshime substanciale në procedurën për ankesa dhe parashtresa.

Ndryshimet kanë përfshirë periudhën kohore brenda së cilës PZAP duhet të vendos mbi ankesat, që është ndryshuar nga 5 ditë në 72 orë, dhe shkurtimin e afatit në 24 orë për dorëzimin e ankesave lidhur me procesin e numërimit. Gjykata Supreme ka zëvendësuar Gjykatën Kushtetuese si organ i shkallës së dytë. Ndryshimet e bëra kanë për qëllim bërjen e procesit më efikas dhe zvogëlimin e mundësive për vonesa në certifikimin përfundimtar të rezultateve të zgjedhjeve. Në këtë aspekt janë dëshmuar si efektive.

PZAP merret me parashtresat kundër vendimeve të KQZ-së lidhur me certifikimin e partive ose të kandidatëve, akreditimin e vëzhguesve, regjistrimin e partive dhe votimin jashtë Kosovës. KQZ është e obliguar të zbatojë vendimet e PZAP-së për parashtresat. PZAP po ashtu merret me ankesat lidhur me zhvillimin e fushatës, votimin, numërimin dhe rezultatet dhe po ashtu pranon ankesat e parashtuara pas shpalljes së rezultateve përfundimtare. Ankuesit kanë 24 orë pas mbylljes së vendvotimeve që të dorëzojnë ankesat lidhur me procesin e votimit dhe 24 orë nga shkelja e pretenduar për ato që kanë të bëjnë me shkeljen e periudhës së heshtjes dhe me numërimin dhe rezultatet ose kundërshtimin e rezultateve para certifikimit përfundimtar. Ndonëse afatet kohore për kontestet zgjedhore duhet të jenë të shkurtra, duhet të merret parasysh mundësia për zgjatjen e afatit për parashtrimin e ankesave në 48 orë. Ankuesit shpesh nuk janë në dijeni të shkeljeve brenda një afati 24 orësh, duke lënë kështu shkeljet ligjore pa pasojë ligjore.

Sido që të jetë, PZAP ka 72 orë nga momenti i pranimit të ankesës për të marrë vendim. Për më shumë, vendimet e PZAP-së, edhe për ankesa edhe për parashtresa, mund të ankimohen në Gjykatën Supreme, nëse gjoha e caktuar është më e lartë se 5,000 euro ose nëse çështja ka të bëjë me të drejtë themelore. KQZ duhet të certifikojë rezultatet përfundimtare vetëm pasi PZAP të ketë vendosur për të gjitha parashtresat dhe pasi Gjykata Supreme të ketë vendosur për të gjitha ankesat kundër vendimeve të PZAP-së.

PZAP ka pranuar gjithsej 340 parashtresa dhe ankesa. Nëntëdhjetë e gjashtë janë aprovuar dhe të tjerat janë refuzuar ose nuk janë pranuar për shkak të formës ose substancës. Nga parashtresat dhe ankesat e refuzuara, 15 janë ankimuar në Gjykatën Supreme, ku janë vërtetuar vendimet e PZAP. Gjykata Supreme nuk i publikon vendimet e veta.

Parashtrues i ankesës mund të jetë çdo person, fizik apo juridik, me interes ligjor për një çështje, ose të drejtat e të cilit lidhur me procesin zgjedhor mendohet të jenë shkelur. Këta janë votuesit, subjektet politike, pjesëtarët e organeve të menaxhimit të zgjedhjeve, ose vëzhguesit e partive politike. Megjithatë, niveli i vetëdijes për procedurat e PZAP-së tek publiku në përgjithësi dhe tek subjektet politike të vogla dhe jo-shumicë është shumë i vogël, veçanërisht në komunat me shumicë serbe. Si pasojë, shumica e parashtresave dhe ankesave janë paraqitur nga subjektet më të mëdha politike. Ato më të voglat kanë dorëzuar vetëm disa parashtresa, dhe shumë prej tyre janë refuzuar për shkak të formës. Nga të gjitha parashtresat e marra nga PZAP, gjashtë ishin nga katër komunat veriore; vetëm 26 ishin të parashtuara nga subjektet politike të komuniteteve jo-shumicë, prej të cilave tetë ishin nga subjektet politike serbe.

Në trajtimin e ankesave dhe parashtresave, PZAP ka vepruar sipas ligjit dhe rregulloreve të veta të brendshme, duke ndjekur procedurat dhe duke respektuar afatet. Paneli ka bashkuar parashtresat e ngjashme nga zonat e njëjta gjeografike ose ato të natyrës së njëjtë, dhe i ka trajtuar si një. Paneli ka

treguar bazën ligjore për vendimet e tij dhe vendimet janë publikuar me kohë në faqen e internetit të PZAP-së, edhe pse jo gjithmonë është siguruar përkthimi në gjuhën serbe.

Megjithatë, në shumë raste, PZAP ka pasur qasje formaliste dhe jo gjithmonë ka hulumtuar për prova në mënyrë proaktive. Ka zgjidhur mjaft parashtrës në mungesë të provave të domosdoshme. Si pasojë, shumë nga këto i ka refuzuar. Vetëm një parashtrës nga Dita e Zgjedhjeve ka rezultuar me rinumërim të një vendvotimi. Megjithatë, në përgjithësi ka rritje të numrit të parashtrësve të aprovuara, veçanërisht atyre lidhur me fushatën, periudhën e heshtjes dhe shpalljen e rezultateve. Për dallim nga gjobat e konsiderueshme që u janë shqiptuar subjekteve politike për shkelje të rregullave të fushatës, prej gjithsej 56 parashtrësve lidhur me votimin, vetëm një, që kishte të bënte me blerje të pretenduar të votës, ka rezultuar në gjobë të ashpër.

Si edhe në zgjedhjet e mëhershme, PZAP nuk ka shfrytëzuar mundësinë e mbajtjes së seancave dëgjimore. Në rastet e dyshimit se parashtrës mund të përmbajë aktivitete mashtruese, PZAP ka mundësinë të caktojë ekipe hetimore në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. PZAP ka përdorur këtë mjet të rëndësishëm në disa raste. Ai ka dërguar një ekip hetimor të përbërë nga gjyqtarë dhe një zyrtar ligjor i Sekretariatit në QNR, kur pesë subjektet politike janë ankuar duke pretenduar se ka manipulim të votave nga votimi jashtë Kosovës. Po ashtu ai ka dërguar ekipe hetimore në QNR kur ka zgjidhur parashtrësat e paraqitura pas shpalljes së rezultateve. Kjo i ka lejuar panelit të marrë vendime më të informuara në bazë të provave të dokumentuara, që ka rezultuar në aprovim të shumë prej këtyre parashtrësve dhe urdhër për ri-numërim të 51 kutive të votimit.

Shkeljet që mund të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve, përpos që paraqesin shkelje administrative, ato mund të paraqesin edhe vepra penale. Në raste të tilla, PZAP duhet të dërgojë çështjen në Zyrën e Kryeprokurorit dhe në polici, për të ndjekur çështjen penalisht. Kjo nuk duhet të zhvesh PZAP-në nga juridiksioni i vet për të përcaktuar përgjegjësinë administrative. Bashkëpunimi i PZAP-së me policinë dhe prokurorinë është përmirësuar dhe shkëmbimi i informacioneve ka rezultuar në aprovim të parashtrësve në së paku dy raste. PZAP ka qenë i zellshëm për t'ia dërguar prokurorit informacionet për rastet kur ka pasur dyshime për aktivitetet kriminale lidhur me të drejtat zgjedhore.

Edhe pse EU EOM ka vërejtur një përmirësim në punën e bërë nga PZAP gjatë këtyre zgjedhjeve, është e diskutueshme nëse formati i zgjedhur për t'u marrë me kontestet zgjedhore (një organ i përhershëm me panele të gjykatësve me orar të plotë) është më i përshtatshmi. Pjesa më e madhe e punës, prej marrjes së parashtrësve e deri te përpunimi i rasteve, udhëheqja e hetimeve dhe përgatitja ligjore e vendimeve, bëhet nga Sekretariati.

XII. VËZHGIMI VENDOR

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullorja e KQZ parasheh vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë të zgjedhjeve. KQZ ka lëshuar 36,043 akreditime për vëzhguesit e zgjedhjeve, përfshirë përfaqësuesit e partive politike dhe mediat, duke rritur transparencën e procesit. Më shumë se 31,000 kanë qenë nga subjektet politike, ku PDK, AAK dhe LDK kanë pasur shumicën e përfaqësuesve. KQZ po ashtu ka akredituar mbi 3,000 vëzhgues të organizatave të shoqërisë civile.

Grupi më i madh i vëzhguesve vendorë ka qenë nga Demokracia në Veprim (DnV), platformë që ka përfshirë afër 80 organizata joqeveritare (OJQ) dhe asociacione. DnV ka përcjell fushatën dhe ambientin parazgjedhor me 100 vëzhgues afatgjatë dhe vëzhgues të shpërndarë në shumicën e vendvotimeve. Vëzhguesit e DnV kanë bërë vëzhgim stacionar, me tre formularë për hapjen, votimin dhe mbylljen dhe numërimin, të cilat ata i kanë raportuar përmes telefonit. Duket se vëzhguesit e DnV ishin me përvojë dhe kishin njohuri për procedurat e Ditës së Votimit.

Forumi i organizatës Demokracia për Zhvillim (D4D) ka program të gjerë zgjedhor dhe ka disa publikime për çështje lidhur me zgjedhjet. D4D ishte e vetmja organizatë e shoqërisë civile e zgjedhur nga KQZ¹² për të pasur rol në edukimin e votuesve. Ata kanë hartuar dhe shpërndarë fletushka informative që në të shumtën e rasteve janë marrë me bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore, për të parandaluar keqpërdorimin e votës.

XIII. VOTIMI DHE NUMËRIMI

EU EOM ka vëzhguar hapjen, votimin dhe mbylljen në 510 vendvotime në 37 komuna¹³. Kjo paraqet më shumë se një të katërtën e numrit të përgjithshëm të vendvotimeve në Kosovë. Zgjedhjet kaluan në mënyrë të qetë dhe pa incidente në vendvotime. Procedurat e hapjes, votimit, mbylljes dhe numërimit në ditën e zgjedhjeve ishin vlerësuar pozitivisht nga vëzhguesit e EU EOM. Qytetarët shprehën të drejtën e tyre demokratike për të votuar, përfshirë edhe në veri. Janë raportuar disa raste të shpërdorimit, të cilat janë adresuar nga autoritetet përkatëse.

Vëzhguesit e EOM kanë vlerësuar paraqitjen e KVV-ve si “ shumë të mirë” dhe “të mirë” në 95.3% të rasteve gjatë votimit dhe e vlerësuan punën e tyre si profesionale.

Në Ditën e Zgjedhjeve, vëzhguesit e EU EOM kanë parë së paku një vëzhgues vendor të pranishëm në 91% të vendvotimeve, prej të cilëve 31% ishin femra. DnV ishte organizata më e pranishme dhe janë vërejtur në 82% të vendvotimeve. Vëzhguesit e akredituar të subjekteve politike kanë qenë të pranishëm në shumicën dërmuese të vendvotimeve, por vetëm 17% e tyre kanë qenë femra. Partia më e përfaqësuar ka qenë LDK, e pranishme në 80% të vendvotimeve, e pasuar nga PDK (në 78%), Vetëvendosje (në 77%). Vëzhguesit e BE-së kanë raportuar se qëndrimi i tyre në përgjithësi ka qenë profesional. Ata kanë vlerësuar të kuptuarit e procesit nga ana e tyre si “të mirë” apo “shumë të mirë”.

Koha e hapjes në përgjithësi është respektuar. EOM ka vlerësuar pozitivisht administrimin e përgjithshëm të hapjes dhe të gjitha procedurat lidhur me të janë respektuar në masë të madhe. Votimi është kryer në mënyrë pozitive në të gjitha vendvotimet e vëzhguara. EU EOM e ka vlerësuar atë si “shumë të mirë” apo “të mirë” pothuajse në të gjitha rastet; transparenca e procesit ka qenë po ashtu vazhdimisht e garantuar. Vëzhguesit e EU EOM kanë mundur t’i vëzhgojnë votimet pa pengesa dhe kufizime.

Fshehtësia e votës nuk është siguruar çdoherë. Edhe pse votimi i asistuar nuk është i ndaluar me ligj, EU EOM ka vërejtur një numër të konsiderueshëm të votimit të asistuar (vërejtur në 23% të vendvotimeve). Sidoqoftë, EU EOM ka vërejtur se kjo ndihmë kryesisht është ofruar nga anëtarët e familjeve dhe jo nga anëtarët e KVV-ve apo vëzhguesit që përfaqësonin partitë politike. Në Zveçan, vëzhguesit e BE kanë qenë dëshmitarë kur një votues e ka hedhur votën në më shumë se një vendvotim. Kjo vërejtje është mbështetur nga vëzhguesit vendorë të cilët pretenduan se ky nuk ishte rast i veçantë.

Votuesit e regjistruar në listën përfundimtare të votuesve, në pajtim me vendimin e KQZ-së, janë lejuar të votojnë me çfarëdo dokumenti të identifikimit, përfshirë edhe letërnjoftimin serb apo letërnjoftimin e skaduar të UNMIK-ut. Kryesisht janë ndjekur procedurat për të siguruar integritetin e votës. Sidoqoftë, KVV-të nuk i kanë kontrolluar gjithmonë gjurmët e ngjyrës në 5% të rasteve dhe verifikimi i identitetit të votuesit nuk është vërtetuar gjithmonë në 4%. Struktura e vendvotimit

¹² Vendimi i KQZ-së 1106/2014 i datës 23 maj 2014.

¹³ Dizajni i metodës së sondazhit për fazën e votimit është ‘stratified random sample’. Mostra ka përfshirë 277 qendra votimi, ku ‘strata’ janë 37 prej 38 komunave të Kosovës. Për shkakë sigurie vëzhgimi nuk është bërë në Zubin Potok. Me nivel besueshmërie prej 95% dhe interval besueshmërie prej 95% margjina e gabimit është 2.4%. Shkalla e reagimit është 67.7%. Metoda e raportimit bazohet në sondazh nga interneti: Computer-Assisted Self Interviewing (CASI). Aty ku nuk ka pasur rrjet interneti, është përdorur Computer-assisted telephone interviewing (CATI). Sondazhi bazohet në 3 seksione: hapja (7h), votimi (7h-19h), mbyllja dhe numërimi (19h). Metoda e sondazhit i referohet vetëm seksionit mbi votimin. Periudha e mbledhjes së të dhënave ka qenë 8 dhe 9 qershor 2014.

në përgjithësi ka qenë e përshtatshme për të zhvilluar votimin dhe për të mbrojtur fshehtësinë e votës. EU EOM po ashtu ka vëzhguar zhvillimin e votimit me kusht në vendvotimet e dyfishta¹⁴ në disa komuna dhe ka konstatuar se në përgjithësi janë respektuar procedurat.

Numërimi në vendvotimet e vëzhguara në përgjithësi është vlerësuar pozitivisht dhe është kryer në mënyrë transparente. Sipas vëzhguesve, qëllimi i votuesve në përgjithësi është respektuar, kur ka qenë i qartë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me legjislacionin e Kosovës. Sidoqoftë, KVV-të kanë pasur disa vështirësi në organizimin sistematik të numërimit. Veçanërisht, KVV-të nuk i kanë plotësuar gjithmonë në mënyrë të saktë Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe të Rezultateve (FPR) dhe nuk i kanë llogaritur në mënyrë të saktë preferencat për kandidatët. Kjo e ka vonuar shumë përfundimin e numërimit dhe ka ndikuar në integritetin e përgjithshëm të numërimit.

Faqja internetit e KQZ-së ishte përditësuar gjatë ditës së zgjedhjeve, përmes programit K-vota, që ofron informata jozyrtare lidhur me pjesëmarrjen dhe rezultatet preliminare pas numërimit. Sidoqoftë, rezultatet preliminare nuk ishin komplete dhe sistemi është i hapur për gabime të faktorit njeri¹⁵.

Pas numërimit, EU EOM ka përcjell transportin e materialit zgjedhor deri në KKZ-të përkatëse dhe ka vëzhguar fazën e pranimit në 28 KKZ. Misioni ka vënë në dukje se integriteti i materialit dhe transparenca e veprimeve kanë qenë të garantuara në të gjitha KKZ-të e vëzhguara.

XIV. NUMËRIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

Korniza ligjore nuk vendos afat për KQZ-në që të shpallë dhe certifikojë rezultatet përfundimtare.

Tabelimi i rezultateve nga vendvotimet e rregullta dhe numërimi i fletëvotimeve prej jashtë Kosovës, të personave me nevoja të veçanta dhe atyre me kusht është bërë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në Fushë Kosovë. Përderisa vëzhguesit e EU EOM mendojnë se procedurat janë ndjekur me korrektësi, ritmi i ngadaltë i numërimit ka vonuar shumë shpalljen e rezultateve. Vetëm më datën 16 qershor, një javë pas zgjedhjeve, QNR ka rritur numrin e ekipeve të numërimit nga shtatë në 20.

Pranimi i materialit nga e tërë Kosova në QNR është përfunduar me 9 qershor. Pas kësaj, 35 kuti të votimit janë vendosur në karantinë. Sipas vendimit të KQZ-së, 14 nga këto kuti janë hapur dhe janë numëruar fletëvotimet për shkak të disa mospërputhjeve, numrave të pasaktë të vulave, apo formularëve të pakompletuar. EOM ka vëzhguar rinumërimin, i cili ishte zhvilluar sipas rregullave. Një nga 14 kutitë e fletëvotimeve nga Lipjani, nuk është marrë parasysh sepse përkundër rinumërimit ka pasur më tepër nënshkrime se sa fletëvotime në kutinë e fletëvotimeve.

Pas përfundimit të fazës së pranimit, QNR filloi skanimin e të gjitha listave të votuesve dhe regjistrimin e të dhënave të formularëve të rezultateve për të gjitha kutitë e rregullta të votimit. Ky veprim zgjati shtatë ditë. Në rast të mospërputhjeve të rezultateve, madje edhe për një rezultat të vetëm, është bërë kontrolli. Më shumë se 400 nga 2,374 vendvotime nuk e kanë kaluar fazën e kontrollit, që do të thotë se ka pasur mospërputhje të një numri të caktuar votash me Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR) dhe Formularët e Rezultatit të Kandidatëve (FRK). Kontrolli rezultoi me dy vendime të KQZ-së me 17 qershor që të rinumërohen 439 kuti

¹⁴ Fletëvotimet me kusht mund të hedhen vetëm në vendvotime të dyfishta të pajisura me kuti votimi shtesë dhe material të domosdoshëm, siç është lista e votuesve me kusht, zarfi sekret. Në secilën qendër votimi gjendet edhe vendvotimi i dyfishtë.

¹⁵ Pas Ditës së Zgjedhjeve, komuna e Fushë Kosovës gabimisht ka treguar për mospërputhje prej më shumë se 20,000 në mes të numrit të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve të gjetura në kuti. Kjo është korrigjuar vetëm pas një jave.

votimi¹⁶. Ka pasur mospërputhje të numrit të fletëvotimeve të hedhura për partitë në 18 raste dhe protokolli në 421 vendvotime ka pasur mospërputhje/gabime në numrin e votave të numëruara për preferencat për kandidatët individualë¹⁷. Për më tepër, në përputhje me vendimin e PZAP-së për një parashtesë të PDK-së, janë rinumëruar edhe dy kuti të tjera të votimit nga Skenderaj.

Gjatë kësaj faze, nëntë vendvotime të tjera janë numëruar pa vendim formal të KQZ-së. Tetë nga këto vendvotime janë numëruar për shkak të mungesës së disa faqeve të FRK-së. Megjithëse lista e këtyre vendvotimeve ishte e bashkangjitur në dokumentin e paraqitur nga FRK për KQZ-në, kjo temë e veçantë nuk është trajtuar asnjëherë në mbledhjet e KQZ-së. Edhe një vendvotim¹⁸ tjetër është rinumëruar sepse përmbante më tepër fletëvotime se sa nënshkrime. Sipas rregullave të cilat i përdor QNR-ja gjatë punës së saj, mospërputhja e tolerueshme në mes të numrit të nënshkrimeve dhe numrit të fletëvotimeve në kuti nuk mund të jetë më i madh se tre¹⁹. QNR zakonisht bën rinumërimin në bazë të vendimit që merr KQZ-ja. Në këtë rast, i vetmi vendim i KQZ-së që është miratuar kishte të bënte me heqjen e rezultateve të këtij vendvotimi nga rezultatet e përgjithshme. QNR ka rinumëruar gjithsej 465 vendvotime²⁰ (19.58% e numrit të përgjithshëm) para shpalljes së rezultateve përfundimtare.

Sipas KQZ-së, 23,984 fletëvotimet me kusht (përfshirë edhe votat e personave me nevoja të veçanta) ishin hedhur në 798 vendvotime të dyfishta. Identiteti i votuesve me kusht paraprakisht është krahasuar me listat e votuesve që votojnë në mënyrë të rregullt, në mënyrë që të zbulohet ndonjë votim eventual i dyfishtë. Pas fazës së pranimit, KQZ-ja ka refuzuar 374 fletëvotime me kusht nga 21 vendvotime, për shkak se nuk ishin ndjekur të gjitha procedurat dhe kishte më shumë fletëvotime të hedhura se sa nënshkrime në listat e votuesve. Pastaj, KQZ-ja ka refuzuar 1,680 fletëvotime me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta (7%) ku votuesi del të ketë votuar më shumë se një herë ose nuk ka qenë në listën e votuesve. Edhe pse këso rastesh mund të gjenden në të gjitha komunat në tërë Kosovën, përqindja më e madhe e refuzimeve ishte në Leposaviq (46.22%), Mitrovicën Veriore (39.25%), Zubin Potok (35.71%), Mamushë (31.71%) Zveçan (30.00%). Numërimi i fletëvotimeve me kusht dhe nga personat me nevoja të veçanta ka përfunduar me 19 qershor.

Sipas rezultateve të KQZ-së, përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme ishte 4%. Kjo paraqet përmirësim të dukshëm krahasuar me zgjedhjet e fundit. QNR ka publikuar një listë prej 43 vendvotimeve ku përqindja e fletëvotimeve të parregullta tejkalonte 10%, por nuk janë ndërmarrë veprime apo vendime të tjera nga KQZ-ja. Ky është një fenomen i përhapur nëpër të gjitha komunat dhe mund t'i atribuohet ndërlikueshmërisë së fletëvotimeve dhe sistemit të votave preferenciale.

XV. PROCEDURA PËR FORMIMIN E QEVERISË

Rezultatet preliminare treguan se koalicioni Misioni i Ri i udhëhequr nga PDK mori numrin më të madh të votave. Megjithatë, ai nuk mori shumicën e mjaftueshme (61 ulëse) për të formuar qeverinë. Një ditë pas zgjedhjeve, tri parti (LDK, AAK dhe Nisma) nënshkruan aleancën paszgjedhore, e cila bashkë me përkrahjen e Vetëvendosjes, do të mjaftonte për të formuar

¹⁶ Vendimi i KQZ-së 1416/2014 i datës 17 qershor 2014 dhe vendimi i KQZ-së 1417/2014 i datës 17 qershor 2014.

¹⁷ Shumica e këtyre rasteve ishin kur: një kandidat mori më shumë vota preferenciale se sa numri i përgjithshëm i votave të partisë së tij/saj; një subjekt politik pati vota në formularin e rezultateve, por asnjë kandidat i këtij subjekti s'kishte marrë vota; ose përqindja e votave të pavlefshme ka qenë më e lartë se 10 për qind.

¹⁸ PS 2106B/01R në Skenderaj

¹⁹ Kësaj i referohemi si niveli i tolerancës por nuk ka ndonjë tekst ligjor për këtë rregull. Për më tepër, nuk është e mundur të dihet sa vendvotime kanë pasur mospërputhje që kanë qenë brenda këtij niveli të tolerancës.

²⁰ Në këtë total janë të përfshira edhe 14 kuti të votimit të futura në karantinë pas pranimit dhe rinumërimit; dy kuti të tjera shtesë janë numëruar gabimisht.

qeverinë. Që nga ky moment, filloi polemika se cili prej koalicioneve partiake duhet të formojë qeverinë, bazuar në interpretimet kundërthënëse të Kushtetutës së Kosovës.

Sipas Kushtetutës, pas zgjedhjeve, Kryetari i Kosovës e propozon kandidatin për Kryeministër, duke u këshilluar me partinë politike apo koalicionin që ka fituar shumicën “e nevojshme në Kuvend për të formuar qeverinë”. Kandidati ka 15 ditë afat për t’ia prezantuar qeverinë Kuvendit. Nëse përpjekja e parë është e pasuksesshme, Kryetari mund të zgjedhë kandidatin e dytë, i cili pastaj ka 10 ditë për të prezantuar qeverinë. Nëse dështon zgjedhja e qeverisë, Kryetari shpall zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda 40 ditësh.

Qëndrimi i koalicionit paszgjedhor AAK-LDK-Nisma është se nëse ata mund të dëshmojnë se ata kanë shumicën e nevojshme, ky koalicion duhet të ftohet që të formojë qeverinë. PDK e kundërshtoi një interpretim të tillë dhe deklaroi se “koalicioni” duhet të kuptohet si koalicion i certifikuar dhe i formuar para zgjedhjeve. Në këtë rast, asnjë parti apo koalicion nuk do të jetë në situatë të tillë, meqë asnjëri nuk ka marrë vota të mjaftueshme. Për më tepër, PDK beson se vetëm partia apo koalicioni më i votuar ka të drejtën të ketë dy mundësitë për të formuar qeverinë. Ky interpretim do të dërgonte në zgjedhje të parakohshme pas 40 ditësh. Sipas këtij interpretimi, është e mundur që zgjedhjet e tjera të prodhonin rezultate të ngjashme, ku partia më e votuar do ta ketë të pamundur formimin e qeverisë.

Presidentja ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese sqarime për këtë çështje me datën 19 qershor. Më datë 1 korrik, Gjykata ka marrë vendim sipas të cilit Presidentja duhet të mandatoj kandidatin për Kryeministër të propozuar nga partia fituese e zgjedhjeve, Misioni i Ri i udhëhequr nga PDK-ja, për të formuar qeverinë. Nëse kandidati nuk merr përkrahjen e nevojshme, mbetet në diskrecion të Presidentes që pas këshillimeve me partitë apo koalicionet, të vendosë se nga cila parti apo koalicion do të kërkojë propozimin për kandidatin e dytë për Kryeministër. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, më tej thekson se Presidentja mund të propozoj edhe kandidatin e dytë për Kryeministër nga partia fituese e zgjedhjeve (Misioni i Ri), por tërheq vërejtjen se është përgjegjësi e Presidentes të ruajë stabilitetin e vendit dhe të gjejë kritere mbizotëruese për formimin e qeverisë së re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e reja.

Vendimi merr parasysh shprehjet e përdorura në Kushtetutë, përfshirë “koalicionin ose partinë” dhe “shumicën e nevojshme për të formuar qeverinë” dhe nxjerr përfundimin se sipas interpretimit të saj, Presidentja duhet të caktojë si kandidat për Kryeministër përfaqësuesin e subjektit më të votuar politik. Duke vepruar kështu, Presidentja duhet të këshillohet vetëm me këtë subjekt politik dhe me asnjë tjetër. Vendimi është përfundimtar në këtë pikë: tentimi i parë për të formuar qeverinë duhet t’i jepet partisë-koalicionit fitues, Misioni i Ri.

Nëse Kryeministri i parë i caktuar nuk mund të formojë qeverinë, Kushtetuta parasheh që Presidentja duhet të caktojë kandidatin tjetër “duke ndjekur të njëjtën procedurë”. Vendimi e shpjegon këtë duke deklaruar se Presidentja mban përgjegjësinë për të vendosur se cilit kandidat duhet t’i jepet mundësia e dytë për të formuar qeverinë. Ndonëse mund t’i jepet kandidatit nga një subjekt tjetër politik, nuk përjashtohet mundësia që Presidentja mund të vendosë t’ia ofrojë këtë një kandidat tjetër nga e njëjta parti apo koalicion që e kishte edhe rastin e parë. Vendimi është jo-përfundimtar në këtë pikë: përpjekja e dytë për formimin e qeverisë mund t’i jepet një kandidat tjetër nga e njëjta parti apo një kandidat nga një subjekt tjetër politik.

Interpretimi i Gjykatës, i kombinuar me kufizimin kushtetuese në dy përpjekje për formimin e qeverisë para se të thirren zgjedhjet e reja, lë të hapur mundësinë që as tani dhe as në të ardhmen, koalicioni paszgjedhor, që përfaqëson shumicën e deputetëve të zgjedhur të Kuvendit, të mos ftohet për të formuar qeverinë. Kjo tregon për një mangësi në Kushtetutë dhe potencialisht përbën sfidë për respektimin e vullnetit të votuesve.

#	Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Metoda
	Korniza ligjore				
	Që afati i përgjithshëm kohor i nevojshëm për të përgatitur zgjedhjet të zgjatet dhe të lejohen afate më të gjata dhe të qëndrueshme kohore për faza të ndryshme të procesit.	Zgjatja e afatit kohor për aplikim dhe ankesë ndaj listës së votuesve, për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve, për aplikim dhe ankesë ndaj listës së votuesve jashtë Kosovës, për periudhën e votimit për votimin jashtë Kosovës.	Ndryshime në LZP	Kuvendi i Kosovës KQZ	Siguria (qartësia) ligjore/stabiliteti i rregullave Kodi i Praktikës së Mirë për Çështje të Zgjedhjeve i Komisionit të Venedikut-CGPEM (VC) Kapitulli 2 E drejta në mjet efikas juridik Neni 13 i KEDNJ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike-ICCPR, neni 2 Zgjedhje të vërteta
	Që në rast të zgjedhjeve të parakohshme të gjitha afatet ligjore të përcaktuara në kuadër të procesit zgjedhor të respektohen me saktësi dhe të mos përkojnë me njëra-tjetrën, në mënyrë që të garantohet ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave zgjedhore nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor	Afati kohor për zgjedhje të parakohshme duhet t'u jap të gjitha palëve të interesuara kohë të mjaftueshme për përgatitje të plotë të zgjedhjeve dhe për ushtrimin e plotë të të drejtave zgjedhore. Para çfarëdo ndryshimi të kornizës ligjore, duhet shmangur shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për më pak se 45 ditë pas shpërndarjes Kuvendit.	Ndryshime në Kushtetutë dhe LPZ	Kuvendi i Kosovës	Siguria ligjore/stabiliteti i rregullave CGPEM (VC) Kapitulli 2 E drejta në mjet efikas juridik KEDNJ neni 13 ICCPR, neni 2 Zgjedhje të vërteta

	Të qartësohet metoda e ndarjes së ulëseve në Kuvendin e Kosovës për të rritur besimin e subjekteve politike dhe votuesve në sistemin zgjedhor	Qartësimi i termave dhe përdorimi i gjuhës së qartë në pajtim me Kushtetutën dhe inkorporimi i gjetjeve të Grupeve Punuese për Shpërndarjen e Ulëseve në LZP dhe në rregullat e veçanta të KQZ-së	Ndryshime në LPZ dhe nxjerrja e një rregulle të veçantë të KQZ	Kuvendi i Kosovës	Siguria ligjore/stabiliteti i rregullave CGPEM (VC), Kapitulli 2 Zgjedhje të vërteta
	Të qartësohet korniza ligjore për zgjedhje	Rregullat e KQZ-së në masë të madhe mund të përfshihen në LZP në mënyrë që të qartësohet korniza ligjore për zgjedhjet	Ndryshime në Kushtetutë dhe LZP	Kuvendi i Kosovës	Siguria ligjore/stabiliteti i rregullave
	Kur asnjë parti apo koalicion parazgjedhor nuk fiton shumicën e ulëseve të sigurohet se do të shteren të gjitha mundësitë për të formuar qeverinë para se të shpallen zgjedhjet e reja.	Ndryshimi i Kushtetutës për të siguruar se cilido koalicion pas-zgjedhor me shumicë të ftohet për të formuar qeverinë. Të mendohet për heqjen e kufizimit që vetëm dy kandidatëve për Kryeministër t'u jepet mundësia të formojnë qeverinë para se të shpallen zgjedhjet e reja.	Ndryshime në Kushtetutë	Kuvendi i Kosovës	E drejta për t'u zgjedhur, ICCPR, neni 25 Vullneti i qytetarëve, DUDNJ, neni 21
	Administrimi i zgjedhjeve				
	Të përmirësohet efikasiteti i administrimit të zgjedhjeve	Të konsiderohet mundësia që t'u jepet më shumë përgjegjësi KKZ-ve, sidomos lidhur me emërimin e KVV-ve dhe me aktivitetet e edukimit të votuesve.	Ndryshime në legjislacionin për zgjedhjet	Kuvendi i Kosovës, KQZ	Zgjedhje të vërteta
	Të përmirësohet	KQZ mund të publikojë rezultatet	Ndryshime në legjislacionin për	Kuvendi i Kosovës, KQZ	Kodi i Praktikës së Mirë në

	transparenca në procesin e tabelimit të rezultateve. Të garantohet mundësia e gjurmimit (përcjelljes) të votës.	me detaje të plota sipas vendvotimeve, përfshirë edhe rezultatet e detajuara për të gjitha vota me kusht, ato të votuesve me nevoja të veçanta dhe votat me postë; anëtarët e KVV-ve dhe vëzhguesit duhet të marrin kopje të formularëve të rezultateve.	zgjedhjet		Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës, l. 3.2.xii
	Të përmirësohet efikasiteti në procesin e tabelimit të rezultateve. Të rritet besimi i publikut dhe besueshmëria në proces.	KQZ mund të angazhojë më shumë njerëz dhe staf teknik në procesin e tabelimit të rezultateve.	Vendim i KQZ-së	KQZ	Zgjedhje të vërteta
	Të informohen votuesit në mënyrë adekuate për procedurat e votimit. Të zvogëlohet numri i fletëvotimeve të pavlefshme.	Duhet të intensifikohen përpjekjet për edukimin e votuesve, në të gjitha gjuhët zyrtare, veçanërisht për plotësimin e fletëvotimit në mënyrë të duhur	Edukim plotësues i votuesve, duke pasur në fokus popullsinë rurale	KQZ	E drejta për të votuar ICCPR, Koment i Përgjithshëm 25, paragrafi 11 Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme
	Të përmirësohet integriteti i procesit të numërimit	Të fuqizohet trajnimi i KVV-ve mbi procedurat e numërimit dhe plotësimit të formularëve. Të gjithë formularët që duhet të plotësohen në vendvotime, veçanërisht FPR dhe FRK, mund të thjeshtohen.	Trajnim më i mirë Ri-hartimi i formularëve	KQZ	E drejta universale dhe e barabartë për votë
	Të arrihet transparenca e plotë e procesit dhe tu sigurohet qasja në informata	Të sigurohet se të gjitha informacionet dhe dokumentet themelore lidhur me zgjedhjet të	Ndarja adekuate e burimeve financiare, teknike dhe njerëzore.	KQZ	Kandidimi në zgjedhje Mundësi të barabarta Qasja në informata

	të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor	përkthehen saktësisht dhe me kohë në gjuhët zyrtare të Kosovës në pajtim me Ligjin për Gjuhët (Materiali informues për votuesit, tekstet kushtetuese dhe ligjore, vendimet dhe komunikimet e KQZ-së, vendimet e PZAP-së)		PZAP	Ligji mbi përdorimin e Gjuhëve
	Lista e votuesve				
	Të përmirësohet saktësia e listës së votuesve	Duhet të forcuar përpjekjet për të përmirësuar saktësinë e listës së votuesve përmes adresimit të mangësive në sistemin e regjistrimit civil, sidomos personat e vdekur që janë në lista dhe gabimet e tjera të regjistrimit.	Përditësimi dhe pastrimi i regjistrit civil	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Regjistrimit Civil në bashkëpunim me KQZ-në	E drejta universale dhe e barabartë për të votuar Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës, 1.2.ii Rregullorja e KQA Nr. 2
	Të përmirësohet saktësia e listës së votuesve	Të lejohet kohë e mjaftueshme për publikim, përmirësim, kundërshtim, konfirmim dhe marrjen të vendimeve për listat e votuesve.	Respektimi i afateve ligjore për publikim të listës së votuesve	KQZ	E drejta për të votuar dhe për mjet juridik ICCPR Art 25(b) KEDNJ, neni 13 ICCPR, neni 2 DUDNJ, neni 8
	Programi Jashtë Kosovës				
	Të përmirësohet integriteti i votës në programin për votim jashtë Kosovës	KQZ mund të parashikoj mekanizma të rinj për të mbrojtur votat përmes postës dhe vërtetësinë e fletëvotimeve.	Ndryshime në Rregulloret e KQZ-së dhe në LPZ	KQZ	Fshehtësia e votës Rregullorja e KQZ-së Nr. 3
	Dita e zgjedhjeve				

	Të përmirësohet integriteti dhe të garantohet fshehtësia e votës	Votimi i asistuar në vendvotime mund të rregullohet në mënyrë më të rreptë, për t'u evituar shpërdorimet.	Rregullorja e KQZ	KQZ	Zbatimi i rregullave të financimit të fushatës në legjislacionin e Kosovës
	Të përmirësohet transparenca dhe integriteti i votës	Mund t'i kushtohet vëmendje zëvendësimit të votimit me kusht me metoda alternative për tu mundësuar votuesve të votojnë jashtë vendvotimit të tyre të caktuar	Ndryshime në LPZ	KQZ Kuvendi i Kosovës	E drejta për të votuar Zgjedhje të vërteta
	Financimi i fushatës				
	Zbatimi efektiv i rregullave për financimin e fushatës dhe transparencës lidhur me donacione dhe shpenzimet e subjekteve politike	Të krijohet një sistemi efektiv i kontrollit dhe auditimit financiar, i cili verifikon jo vetëm dorëzimin e të dhënave nga subjektet politike, por edhe plotësinë saktësinë dhe përputhjen e tyre me shpenzimet dhe burimet e të ardhurave.	Rritja e burimeve të Zyrës së KQZ-së për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin	KQZ	Zbatimi i rregullave të financimit të fushatës në legjislacionin e Kosovës
	Mediat				
	Të sigurohet barazia e garuesve në media gjatë fushatës zgjedhore.	Programet e sponzoruar nga partitë politike të rregullohen ngjashëm me spotet reklamuese politike.	Ndryshimi i nenit 49 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndryshimi i Rregullores KPM-2013/03 të Komisionit të Pavarur për Media mbi Komunikimin Audio-Vizual	Kuvendi i Kosovës, Komisioni i Pavarur për Media	Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 2; Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës, neni 21 i Raportit shpjegues
	Të sigurohet një mjet efikas juridik për ankesat lidhur me mediat gjatë fushatës.	Roli dhe kompetencat e KPM-së gjatë periudhës së fushatës zgjedhore mund të rregullohen	Ndryshimi i Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media	Kuvendi i Kosovës	Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut të

		më hollësisht. Duhet të mbahen takime të rregullta për të shqyrtuar ankesat e pranuar dhe çdo ndëshkim të zbatuar para Ditës së Zgjedhjeve.			Këshillit të Evropës, neni 19 i Raportit shpjegues
	Gjinia				
	Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe në procesin zgjedhor.	Secila gjini duhet të ketë së paku 30 për qind të përfaqësimit në organet e administratës zgjedhore.	Ndryshimi i LPZ-së	Kuvendi i Kosovës, KQZ	Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të individëve dhe grupeve, të cilët janë në pozita të pabarabarta CEDAW, neni 3
	Kontestet zgjedhore				
	T'i jepet ankuesit zgjedhor kohë e mjaftueshme për të përgatitur ankesën dhe paraqitur dëshmitë	Zgjatja e periudhës për paraqitje të ankesës në 48 orë pas zgjedhjeve	Ndryshimi i LPZ-së	Kuvendi i Kosovës	E drejta në mjet efektiv juridik KEDNJ neni 13 ICCPR. Art 2 DUDNJ, neni 8
	Të sigurohet se të gjitha ankesat janë hetuar si duhet	Mbajtja e seancave dëgjimore dhe hulumtimi proaktiv për prova, të bëhet rregull e jo përjashtim	Ndryshimi i LPZ-së dhe rregulloren e brendshme të punës së PZAP-së	Kuvendi i Kosovës, PZAP	Transparenca E drejta për seancë

					dëgjimore CGPEM (VC), 3.3. h)
	Të rritet transparenca e procesit të parashtrësive dhe ankesave	PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të publikojnë me kohë parashtrësat, ankesat, dhe vendimet në të gjitha gjuhët zyrtare në faqen e internetit të saj	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat	Kuvendi i Kosovës, PZAP dhe Gjykata Supreme	Transparenca
	Procesi i ankimimit për shkeljet zgjedhore të sillt më afër votuesve dhe të lehtësohen kufizimet në kapacitetet e PZAP	Mund të merret parasysh decentralizimi i procesit të ankimimit, duke e bërë zyrën kryesore të PZAP-së organ i apelit	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat Ndryshimi i LPZ-së	Kuvendi i Kosovës	E drejta në mjet efektiv juridik KEDNJ neni 13 ICCPR. Neni 2 DUDNJ, neni 8

Legjenda e instrumenteve rajonale, ndërkombëtare dhe dokumentacioni i aplikueshëm teknik dhe informativ		
	Referencat dhe niveli i përkushtimit të Kosovës	
A	Kodi i Praktikës së mirë për Çështjet Zgjedhore. Udhëzuesi dhe Raporti Shpjegues, miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën e 52-të, 18-19 tetor 2002.	
B	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor 1948	DUDNJ
C	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e ndryshuar nga protokolli nr. 14, 1 qershor 2010	KEDNJ
D	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj, 23 mars 1976	ICCPR
E	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, 3 shtator 1981	CEDAW

Aneksi 1: Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2014 – Rezultatet e Përgjithshme Subjektet Politike

Subjekti Politik	Votat	%	Ulëset
PDK- PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	222.181	30,38%	37
LDK – LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES	184.596	25,24%	30
VETVENDOSJE	99.397	13,59%	16
AAK – ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	69.793	9,54%	11
NISMA PER KOSOVEN	37.681	5,15%	6
SRPSKA LISTA- (Lista Serbe)	38.199	5,22%	9
KOALICIJA VAKAT – (Koalicioni Vakat)	6.476	0,89%	2
KNRP - KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA (Partia e Re e Romëve të Kosovës)	645	0,09%	1
KDTP - KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI (Partia Demokratike Turke e Kosovës)	7.424	1,02%	2
PAI - PARTIA E ASHKALINJEVE PER INTEGRIM	1.583	0,22%	1
PDAK - PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS	3.335	0,46%	1
PDS - PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA (Partia Progresive Demokratike)	5.973	0,82%	1
NDS - NOVA DEMOKRATSKA STRANKA (Partia e Re Demokratike)	2.837	0,39%	1
PLE - PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	1.960	0,27%	1
KOALICIJA ZA GORA – (Koalicioni për Gorën)	1.193	0,16%	1

